

REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Shoq. Zogonide UKSH Nr.Prot. 1553, Data 7.6.2024

Shkurtimi i lëndës dërkohet mendim për ndryshim nivelit të korripove

Për trajtim nga:

- N/Kryetar
- N/Kryetar
- N/Kryetar
- Kabineti Z.
- Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit
 - 1. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
 - 2. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
 - 3. Drejtoria e Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme
 - 4. Drejtoria e Aseteve dhe Kadastrës Urbane
- Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik
 - 1. Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit
 - 2. Drejtoria e Turizmit
 - 3. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP
- Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike
- Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike
- Drejtoria e MZSH
- Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës, Arsimit dhe Sportit
 - 1. Drejtoria e Sportit
 - 2. Drejtoria e Arsimit
 - 3. Drejtoria e Kulturës
 - 4. Teatri "Migjeni"
- Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
 - 1. Drejtoria Juridike
 - 2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore
 - 3. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
 - 4. Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit ZIN dhe TIK
- Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve Sociale dhe Rinisë
 - 1. Drejtoria e Shërbimeve Sociale
 - 2. Drejtoria e Ndihmës Ekonomike
- Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar
 - 1. Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor
 - 2. Drejtoria e Financës
 - 3. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore
- Q.Trajtimit të Studentëve
- Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç
- Shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç
- Qendra e Zhvillimit
- Nj.A Ana e Malit
- Nj.A Bërdicë
- Nj.A Dajç
- Nj.A Guri i Zi
- Nj.A Postribë
- Nj.A Pult
- Nj.A Rrethina
- Nj.A Shalë
- Nj.A Shosh
- Nj.A Velipojë
- Lagje
- Drejtoria e Komunikimit dhe Promovimit të Territorit
- Këshilli Bashkiak
- Njësia e Menaxhimit të projekteve strategjike
- Policia Bashkiake
- Emergjencat Civile
- Njësia e Prokurimit
- Njësia e Auditit
- Ujësjetës Kanalizime Shkodër Sh.a.
- IMT
- Gjendja Civile
- Administrimi dhe Inspektoriati i Pyjeve
- Bio Strajca sh.a

fati: Normal (7 ditë) | Prioritet (3 ditë) | Urgjent (brenda ditës) | Pa afat/për djene | Tjetër ___ ditë

Data 7.6.2024, Nr.Prot. 12456
Shënime të Kryetarit:

Nënshkrimi: Benet Beci

Marrë në dorëzim: 11.6.2024

Nënshkrimi Sela

VENI ME KËSHILLIM, SHKRESA, KËRKËS
NR 12456 DATA 7.6.2024
DREJTORIA
E TITULLARIT:



SHOQËRIA E TITULLARIT:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

Nr. 1553 Prot

Data 06.06.2024

Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Kryetar

Z. Oltion LULI

Lënda: Kërkohe mendimi i Këshillit Bashkiak për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura

I nderuar Z.LULI,

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër, ka vlerësuar situatën financiare dhe ka parë domosdoshmërinë e nevojës për të rishikuar nivelin e tarifave për shërbimet që ofrojmë.

Në vijim të vendimit të miratimit të tarifave nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë, ju dërgojmë për diskutim dhe shprehje të mendimit në lidhje me nivelin e ri të tarifave për ofrimin e shërbimit të ujit të pijshëm dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura, sipas tabelës më poshtë:

Kategoria e Klientëve		Tarifat Aktuale	Tarifat e Propozuara për Vitet 2025-2027
A. Shërbimi i Furnizimit me Ujë		Lek/m ³	Lek/m ³
Njësia Shkodër	1. Konsumatorë Familjarë	40	70
	2. Konsumatorë Publik	110	140
	3. Konsumatorë Privat	110	140
B. Shërbimi i Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura		Lek/m ³	Lek/m ³
Njësia Shkodër	1. Konsumatorë Familjarë	15	40
	2. Konsumatorë Publik	20	50
	3. Konsumatorë Privat	20	50
C. Tarifë Fikse Shërbimi		Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
Njësia Shkodër	1. Konsumatorë Familjarë	100	200
	2. Konsumatorë Publik	100	300
	3. Konsumatorë Privat	100	300



REPUBLIKA E SHqipërisë

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

Gjithashtu, bashkëlidhur po ju përcjellim relacionin teknik dhe ekonomik mbi të cilën bazohet nevoja për nivelin e ri të tarifave.

Me respekt,

ADMINISTRATORI





RELACIONI I GJENDJES TEKNIKO – EKONOMIKE

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër
Sh.a

ABSTRAKT

Rritja e mbulueshmërisë me shërbim dhe e qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë janë objektivat që synon të arrijë shoqëria rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër, në periudhën afatmesëm. Me anë të këtij relacioni paraqesim gjendjen aktuale tekniko-ekonomike të shoqërisë, si dhe propozimin për tarifat e reja të shërbimit, me qëllim arritjen e qëndrueshmërisë financiare të saj.

d'ie e
A janë
sua-
shër
qësin
së, si
ri, me

Die a
jabe
st
empe
amido
Sj, a
U, my

RELACIONI I GJENDJES TEKNIKO – EKONOMIKE

Përmbajtja	
HYRJE	2
I. GJENDJA TEKNIKE.....	2
1.1 Sistemet e furnizimit me ujë.....	2
1.1.1 Burimet e ujit/veprat e marrjes për furnizimin me ujë të Bashkisë Shkodër.....	2
1.1.2 Furnizimi me ujë zona rurale e Bashkisë Shkodër.....	5
1.2 Sistemet e kanalizimit	8
1.2.1 Sistemet e kanalizimit të ujërave të ndotura të Bashkisë Shkodër	8
1.2.2 Sistemet e kanalizimit të ujërave të Shiut në Bashkinë Shkodër	9
1.2.3 Impiante të trajtimit të ujërave të ndotura	10
1.3 Investimet e viteve të fundit në sistemet e shpërndarjes	13
1.4 Struktura Organizative	16
1.5 Zona e shërbimit.....	17
1.6 Plotësimi I kërkesave të VKM Nr. 23 dt, 09.01.2008 “Për tarifën e përdorimit të ujit”	19
1.7 Efiçenca e energjisë.....	20
1.8 Gjendja e aseteve të shoqërisë rajonale ujësjellës Kanalizime Shkodër	20
II. RELACIONI SHPJEGUES EKONOMIK QË MBËSHTET PROPOZIMIN PËR NDRYSHIM TË TARIFAVE TË SHËRBIMEVE UK PËR SHOQËRINË RAJONALË UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR	21
2.1 Situata e përgjithshme financiare e shoqërisë	21
2.2 Llogaritja e nivelit të ri të tarifave për shërbimet që ofron shoqëria	27
2.3 Plotësimi i objektivave të mëparshme dhe synimi i objektivave të reja.....	28
2.4 Justifikimi i tarifës së re të kërkuar	32
2.4.1 Tarifa mesatare për metër kub ujë i pijshëm dhe kanalizime	33
2.4.2 Vlerësimi i Përbalueshmërisë.....	34

HYRJJE

Në zbatim të VKM-së nr 302 datë 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, është krijuar Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve Shkodër sh.a (UKRSH) që ofron shërbime për furnizimin me ujë dhe mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura për popullsinë e Bashkive: Shkodër, Malësi e Madhe, Fushë-Arrëz, Pukë dhe Vau Dejës. Shoqëria publike operon mbi baza tregtare në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Aksionerët e shoqërisë janë: MIE 51%, Bashkia Shkodër 36.33%, Bashkia Malësi e Madhe 6.39%, Bashkia Vau Dejës 3.23%, Bashkia Pukë 2.19%, Bashkia Fushë-Arrëz 0.86%. Aksionerët ushtrojnë vendimmarrjen dhe mbikëqyrjen e tyre nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme (AP) dhe Këshillit Mbikqyrës (KM) të shoqërisë.

Shoqërisë së re të krijuar i duhet të operojë mbi baza tregtare dhe njëkohësisht të ofrojë shërbime cilësorë për klientët e saj, por në situatën në të cilën ndodhet aktualisht kjo shoqëri me nivelin aktual të të tarifave dhe të ardhurave që gjenerohen nga shitja, mbulimi i shpenzimeve operative arrihet vetëm deri në nivelin 75%, ndërsa mbulimi i shpenzimeve totale bashkë me amortizimin arrihet deri në nivelin 40%. Arsyet kryesore për këtë janë:

- Rritja e kostove të pagës minimale gjatë viteve të fundit, të cilat pritet sërish të rritet në të ardhmen.
- Rritja e kostove të materialeve dhe shërbimeve të nevojshme për veprimtarinë e shoqërisë.
- Niveli i lartë i amortizimit të aseteve të shoqërisë dhe nevoja për ndërhyrje riparuese të shumta, në mungesë të investimeve kapitale.

• Niveli i ulët i tarifave të shërbimit që ofrohen nga UKRSH. Njësia e bashkisë Shkodër aplikon të njëjtin nivel tarifash nga viti 2012, ndërkohë që niveli i shpenzimeve është rritur në nivele të konsiderueshme që atëherë.

Më poshtë paraqitet gjendja e përgjithshme teknike dhe ekonomike e shoqërisë rajonale të krijuar në vitin 2023, si dhe domosdoshmëria që ka shoqëria për të rritur tarifën e shërbimit, me qëllim ofrimin e shërbimit cilësor për klientët e saj.

I. GJENDJA TEKNIKE

1.1 Sistemet e furnizimit me ujë

1.1.1 Burimet e ujit/veprat e marrjes për furnizimin me ujë të Bashkisë Shkodër

Sistemi i furnizimit me ujë të Bashkisë Shkodër, përmban 39 puse dhe 8 skema graviteti, 11 stacione pompimi të ujit, 31.7 km rrjet transmetimi dhe 201.21 km rrjet shpërndarje për të gjithë zonën e shërbimit të kompanisë. Raporti i mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë për bashkinë është 58%.

Qyteti i Shkodrës furnizohet me ujë nga stacioni i puseve i Dobraçit, në pjesën veriore të qytetit rreth 3 km nga qendra e qytetit, ndërmjet lumit Kir dhe Liqenit të Shkodrës. Nga të 11 puset në Dobraç, 10 janë funksionalë.

Këta puse janë ndërtuar në vitin 1965. Thellësia mesatare e puseve varion nga 70 në 80 metra. Uji i pompuar nga secili pus dërgohet në rezervuarin ndërmjetës me kapacitet 1,000 m³, nëpërmjet tubacioneve DN 250 në tubacionet DN 400 në distancë nga 150 metra në 1 kilometër.

Sistemi i shpërndarjes për qytetin e Shkodrës është ndërtuar përpara vitit 1970 kryesisht me tubacione çeliku, të cilat janë amortizuar tërësisht. Kjo ka ndikuar në rritjen e kostove të mirëmbajtjes dhe humbjeve në sistemin e furnizimit me ujë. Gjatë viteve të tranzicionit me krijimin e zonave informale, kthimi i zonave industriale në zona banimi dhe shtimi i godinave të biznesit dhe aktiviteteve private, shumë ndërhyrjeve të paautorizuara dhe jo-profesionale me material jashtë standardit dëmtuan rrjetin ujësjellës duke rritur më shumë vështirësinë e mirëmbajtjes si edhe të zgjerimit të rrjetit.

Gjatë vitit 2023, janë bërë 358 ndërhyrje në rrugët dhe sheshet e asfaltuara urbane, si rrjedhojë e çarjeve të tubave. Përveç kësaj janë bërë punime për riparimin e pjesshëm të segmenteve të dëmtuara dhe amortizimit të tubacioneve të ujësjellësit, instalimi i matësave në ndërtesat e banimit, ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të bizneseve dhe institucioneve nga sistemi i furnizimit me ujë, si edhe instalimi i matësave në puset private të klientëve të lidhur me sistemin e kanalizimeve për qëllime të faturimit. Gjithashtu janë marrë masa për përmirësimin e furnizimit me ujë në shkolla dhe qendra shëndetësore në të gjithë bashkinë Shkodër.

Megjithë përpjekjet maksimale e të vazhdueshme të drejtuesve dhe stafit për furnizimin me ujë të klientëve, numri i ankesave të adresuara në degën teknike të kompanisë është i lartë dhe kryesisht lidhet me riparimin e dëmtimeve në tubacionet e shpërndarjes së ujit të pijshëm. Vjetërsia dhe amortizimi i tubacioneve të transmetimit dhe shpërndarjes manifestohet me difekte teknike të shpeshta.

Gjatë vitit 2023 njësia Shkodër e UKRSH, prodhoi 11,778 milion m³ nga të cilat 89.2% me ngritje mekanike dhe 10.8% me vetërrjedhje. Krahasuar me vitin 2022, sasia e vlerësuar e “Uji të Prodhuar” u zvogëlua me 267 mijë m³, sasia e ujit të faturuar pësoi rënie me 102 mijë m³ pavarësisht se numri i lidhjeve me ujin u rrit me +420 lidhje të reja. Treguesi i nivelit të prodhimit, duke qënë se është i vlerësuar dhe jo i matur mund të ketë edhe element pasaktësie, por nga ana tjetër edhe sasia e ujit të konsumuar nga klientët mund të ketë element pasaktësie si pasojë e mos pajisjes 100% e të gjithë konsumatorëve me matësa, faturimi me tarifë aforfë i cili nuk i përgjigjet konsumit real sidomos për konsumatorët në zonat rurale, apo banesat private me oborr.

Treguesi UPA në nivelin 69%, i mbajtur në nivel konstant gjatë viteve të fundit vazhdon të mbetet në nivele shumë të larta. Arsyet kryesore të këtij niveli të lartë të ujit pa të ardhura lidhen me shumë faktorë, si psh:

- Niveli i lartë i amortizimit të tubacioneve të ndryshme, ku 70% e rrjetit vlerësohet se ka një moshe mesatare 40 vjeçare.

- lidhje të paligjshme, sidomos ato të realizuara në tubacionet kryesore të transmetimit në zonën e Dobraçit.

- Lidhje të paligjshme përgjatë rrjetit shpërndarës

- faturimi aforfe

- leximet e gabuara nga faturuesit

Sfidë e madhe për UKRSH-në mbetet përmirësimi i treguesit të Ujit Pa të Ardhura duke ulur humbjet administrative dhe fizike, të cilat ndikojnë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë. Ulja e humbjeve lidhet direkt me menaxhimin e kontrollit të humbjeve sidomos në sistemet e furnizimit dhe veçanërisht humbjet nga lidhjet e paligjshme. Mungesa e zonave të matura të mbyllura (DMA) e vështirëson evidentimin e lidhjeve të paligjshme. UKRSH ka përdorur të gjitha mjetet që disponon për reduktimin e humbjeve, ku mund të përmendim:

- Krijimin e strukturave për monitorimin e terrenit, për evidentimin e lidhjeve të paligjshme të dukshme.

- Instalimi i matësave të ujit tek klientët e të tre kategorive, duke arritur në nivelin 72.8%, të lidhjeve me matës.

- Për përcaktimin e saktë të ujit të prodhuar është kërkuar mbështetja financiare e AKUK, për pajisjen me matës të mëdhenj prodhimi të sistemeve të ujësjellësit.

Në Njësinë Administrative Rrethina janë bërë ndërhyrje/lidhje të paautorizuara në linjën e transmetimit nga stacioni i pompimit në pusetën shpërndarëse Dobraç.

Më poshtë jepet një vështrim i përgjithshëm i elementëve kyç të sistemit të furnizimit me ujë dhe problematikat e lidhura me të:

- **Prodhimi i ujit** - Për qytetin e Shkodrës kapaciteti i prodhimit të ujit është afërsisht 500-600 l/s. Kjo sasi është vlerësuar bazuar në orët e punës të pompave dhe kapacitetin e tyre të pompimit, duke qenë se nuk janë instaluar dhe ose nuk janë në gjendje pune matësat si në stacionet e pompimit ashtu edhe në puset e prodhimit.

- **Stacionet e pompimit** - Njëra nga 11 pompat dërgon ujë në rezervuarin e ri nr. 1 në Tepe 8,000 m³ që është ndërtuar në vitin 2000. Prej dy stacioneve të pompimit në rezervuar, uji pompohet direkt në rrjetin e shpërndarjes së qytetit.

- **Rrjeti i transmetimit** - 5 km tubacione DN 400 mm nga stacioni i pompimit Dobraç në rezervuarin në Tepe. Shqetësimi kryesor janë lidhjet e paautorizuara dhe rrjedhjet në rrjet, për këtë arsye kërkohet investim për rehabilitim.

- **Rrjeti shpërndarës** - Materiali i tubacioneve varion, por materialet më të përdorura janë çeliku dhe HDPE. Të gjitha linjat e reja janë HDPE.

- **Vazhdimësia e furnizimit** - Qyteti i Shkodrës furnizohet 24 orë në ditë me ujë. Sasia e ujit që furnizon qytetin është e mjaftueshme por ka problematikat e mëposhtme:

- oFurnizimi bëhet nëpërmjet pompimit drejtpërdrejt në rrjet,

o Humbjet në rrjet janë prezente për arsye të vjetërsisë dhe amortizimit,

o Operimi i rezervuarit të Tepes vetëm në kohën e pikut nënkupton se presioni është shumë i ulët (afërsisht 1.5 - 2 bar), gjë që detyron klientët të përdorin pompa. Klientët në Shkodër nuk përdorin depozita personale.

• **Cilësia e ujit** – Trajtimi i vetëm është dizinfektimi me klor duke përdorur pompat e injektimit në rezervuarin e ndërmjetëm në stacionin e Dobraçit. Departamenti i Shëndetit Publik dhe Mjedisit në Shkodër kryen analiza ditore të ujit për klorin mbetës në 22 pika kontrolli. Rezultatet i dërgohen çdo ditë UK Shkodër. Gjithashtu edhe stafi i UKRSH realizon analiza ditore të ujit për klorin mbetës në të gjitha pikat ku paraqiten si problem nga DSHP. Çdo vit realizon analizat për monitorimin e cilësisë së ujit për të gjithë parametrat përfshirë ata mikrobiologjik, tregues dhe fiziko-kimikë, për të vlerësuar cilësinë e përgjithshme të ujit për konsum publik në zbatim të VKM Nr. 379 dt. 25.05.2016.

1.1.2 Furnizimi me ujë zona rurale e Bashkisë Shkodër

Dhjetë Njësi të tjera Administrative (NjA) të bashkisë Shkodër, të paraqitura në tabelën më poshtë, operojnë nëpërmjet skemave të furnizimit me ujë të bazuar në puset/sistemet e pompimit, puset e gravitetit ose të kombinuara dhe gravitetit.

Tabela 1: Sistemet e furnizimit me ujë

Njesia Administrative	Puset /sistemet e pompimit	Graviteti
Ana e Malit	2	
Berdice	3	
Guri I Zi	1	
Dajç	5	
Rrethina	3	
Postribe	4	1
Velipoje	6	
Shale		5
Pult	-	-
Shosh		
Total	24	6

Fshati Velipojë dhe zona e plazhit furnizohen nga pesë puse që ndodhen në fshatin Trush. Investimi përfundoi në vitin 2008. Thellësia mesatare e puseve varion nga 70 deri në 80 metra. Janë të paktë fshatrat si Rosek, Kullaj, Gur i Zi dhe Theth që furnizohen skemë graviteti nga burimet e tyre. Pjesa tjetër e fshatrave nën administrimin e UK

Shkodër kanë skema të ndryshme të furnizimit me ujë, duke përfshirë puse, stacione pompimi, rezervuarë, rrjete transmetimi dhe shpërndarjeje.

Në fshatrat e tjerë rrjetet e shpërndarjes dhe ato kryesore të transmetimit janë në gjendje shumë të keqe dhe për këtë arsye dëmtimet dhe rrjedhjet janë të zakonshme. Duke qenë se rrjeti kryesor i transmetimit është shumë i vjetër, rrjedhjet nuk riparohen, ndërsa pjesët e dëmtuara të tubacioneve janë zëvendësuar plotësisht.

Pranë Qaf Shtiqen ka dy rezervuarë të vegjël nga 200 m³ secili. Këta rezervuarë furnizohen me ujë nga rezervuarët kryesorë në Qaf Shtiqen dhe furnizojnë fshatrat Rrjoll, Cas, Luarz dhe Reç me anë të gravitetit.

Ujësjellësi në fshatin Velipojë dhe në zonën bregdetare përbëhet nga:

Rrjeti kryesor i transmissioinit: nga stacioni i pompimit në Trush deri në rezervuarin e Qaf Shtiqeni, rreth 3 km i gjatë.

Tubacionet e shpërndarjes - të rindërtuar pjesërisht vitet e fundit. Materialet janë të ndryshme: çeliku, HDPE.

Trajtimi i ujit në Velipojë bëhet me klor, i cili dozohet automatikisht në depozita. Në fshatrat e tjerë, uji dezinfektohet në rezervuar, duke dozuar klorin manualisht. Statusi i sistemeve në zonat rurale është përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Të dhëna për sistemet e zonave rurale UKRSH

Fshatrat	Nr. i Stacioneve te pompimit	Nr. i rezervuareve	Statusi i rrjetit të shpërndarjes
NJ.A Berdice	3	3	Tepër e amortizuar
Zues	1	1	Shume i amortizuar
Obot	1	1	Shume i amortizuar
Zogaj	1	1	I amortizuar
Dajc	4	4	I amortizuar
Gur i zi	1	1	Shume i amortizuar
Juban	1	1	Jashte sherbimit
NJ.A Shalë	Graviteti	4	Investim i ri
Dragoç i ri	Graviteti		Investim i ri
Mes-Meselin	1	1	Shume i amortizuar
Drisht	1	1	Shume i amortizuar
Ana Malit Oblike	1	2	Shume i amortizuar

Hot i ri	1	1	I amortizuar
-----------------	---	---	--------------

Më poshtë është një përshkrim i situatës së fshatrave të përmendur në tabelën e mësipërme:

Njësia administrative Bërdicë ka në operim tre stacione pompimi dhe tre rezervuarë që përballen me një rrjet shpërndarjeje tejet të amortizuar.

Fshati Zues ka një stacion pompimi dhe një rezervuar që përballlet me një rrjet shpërndarës shumë të amortizuar.

Fshati Obot ka një stacion pompimi dhe një rezervuar që përballlet me një rrjet shpërndarjeje shumë të amortizuar. Stacioni i pompimit është i zhytur 3 m nën tokë, veshja hidroizoluese e mureve dhe e dyshemesë me shumë filtra uji nëntokësor.

Fshati Zogaj ka një stacion pompimi dhe një rezervuar që përballlet me një rrjet të amortizuarshpërndarjeje.

Njësia Administrative Dajç ka 4 stacione pompimi me 4 rezervuarë. Në përgjithësi ujësjellës mestacione, depo uji dhe me rrjetin e mbiamortizuar të shpërndarjes që nuk mbulon as 15% të sipërfaqes së shërbimit në këtë njësi administrative me ujësjellës.

Njësia Administrative Gur i Zi ka një stacion pompimi dhe një rezervuar që përballlet me një rrjetshpërndarjeje të amortizuar rëndë.

Fshati Juban ka një stacion pompimi dhe një rezervuar. I gjithë sistemi i ujësjellësit për fshatin Juban është jashtë funksionit.

Njësia Administrative Shalë zotëron 4 rezervuarë që funksionojnë nën sistemin e gravitetit (investim i ri).

Fshati Dragoç i Ri funksionon me sistemin e gravitetit (investim i ri).

Fshati Mes-Meselin ka një stacion pompimi dhe një rezervuar që përballlet me një rrjet shpërndarjeje shumë të amortizuar, që furnizon me ujë më pak se 50% të zonës së shërbimit.

Drishti ka një stacion pompimi dhe një rezervuar që përballlet me një rezervuar shumë të amortizuar me shumë depërtime ujore dhe me rrjetin kryesor të shpërndarjes që furnizon me ujë më pak se 40% të zonës së shërbimit.

Ana Malit – NJ.A Oblike ka 1 stacion pompimi zhytës me depërtime të ujërave nëntokësore shumë të amortizuara, rrjet shpërndarës shumë të amortizuar si dhe dy rezervuarë uji, linjat e shpërndarjes të të cilit janë shumë të amortizuara.

Fshati Hot i Ri ka një stacion pompimi dhe një rezervuar që përballlet me një rrjet shpërndarjeje të amortizuar.

Për të gjitha sistemet e ujësjellësit të Njësi Administrative dhe fshatrave të marra në administrim rezulton si më poshtë:

- Të gjithë ujësjellësit janë shumë të amortizuar (me përjashtim të Dragoçit të Ri dhe Thethit).
- Ujësjellësat me ngritje mekanike me kosto të lartë konsumi të energjisë elektrike (me përjashtim të Dragoçit të ri dhe Thethit).
- Me kosto të larta funksionimi-mirëmbajtjeje të cilat nuk plotësojnë standardet higjiëno-sanitare.
- Objektet kryesore të sistemit të furnizimit me ujë janë kryesisht në prona private pa rrugë hyrëse për shërbimet e mirëmbajtjes, shërbimet e zëvendësimit të pompave dhe transformatorëve elektrike.
- Furnizimi me energji elektrike nuk është në nivel standard - me shumë luhajtje të tensionit që shkaktojnë prishje të pompave dhe instalimeve elektrike.
- Furnizimi i pjesshëm me energji elektrike në zonën e shërbimit për furnizimin me ujë.
- Personeli i operim-mirëmbajtjes nuk ka aftësitë e nevojshme profesionale.
- Nevojat aktuale për personel tekniko-inxhinierik për funksionimin-mirëmbajtjen e këtyre sistemeve janë mbuluar nga stafi ekzistues i UKRSH, por për shkak të zgjerimit të zonës së mbulimit me shërbimin e ujësjellësit dhe problematikave të hasura deri më tani rezulton të jetë i pamjaftueshëm.
- Rrugët rurale që përdoren për transportin dhe gërmimin për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit në të gjithë zonën ku ndodhen këta tuba uji janë kryesisht të paasfaltuara, gjë që çon në amortizimin e shpejtë të pajisjeve, që UKRSH ka sot dhe në konsumin e lartë të karburantit.

• Cilësia e ujit

Përsa i përket cilësisë së ujit, vlen të theksohet se trajtimi i ujit të sistemit të furnizimit të qytetit dhe Velipojës funksionon me dozimin automatik të klorit në depozita. Në fshatra të tjerë, uji dezinfektohet duke dozuar manualisht klorin. Çdo ditë monitorohen 22 pika të ndryshme në rrjetin e shpërndarjes, duke kryer nga DSHP analiza kimike dhe mikrobiologjike të ujit të pijshëm, për vlerësimin e cilësisë së ujit të pijshëm për konsum publik.

1.2 Sistemet e kanalizimit

1.2.1 Sistemet e kanalizimit të ujërave të ndotura të Bashkisë Shkodër

Mbulimi i përgjithshëm me shërbimin e kanalizimeve i zonës së shërbimit nën juridiksionin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër për Bashkinë Shkodër

është 46%. Në zonën urbane mbulimi me kanalizimet është relativisht më i lartë 82%, por në zonën rurale është shumë më i ulët në nivelin 2.2%. Nga numri total i lidhjeve në rrjetin e kanalizimeve, vetëm 3.6% shkarkohet në ITUN-të e Shirokës dhe Velipojës.

Më poshtë jepet një përshkrim i sistemit:

- Rrjeti i kanalizimeve të qytetit të Shkodrës operon sipas një sistem miks graviteti dhe pompimi. Ujërat e ndotura dërgohen në stacionin e pompimit në hyrje të qytetit të Shkodrës. Nga kjo pikë, ujërat e ndotura pompojnë në derdhjen e lumit Drin, të cilat më pas gjarpërojnë për disa kilometra deri sa derdhen në det. Rrjeti i kanalizimeve të qytetit Shkodër ka afërsisht 150 km gjatësi tubacione betoni me diametër nga 200 mm në 1000 mm.

- Sistemi i kanalizimeve në Velipojë konsiston në kombinimin e ujërave të ndotura, ujërave të shiut dhe ujërave sipërfaqësorë. Pjesërisht operon me gravitet dhe pjesërisht me sistem pompimi, gjë që diktohet nga topografia e zonës.

- Sistemi i kanalizimeve ka dy pjesë kryesore: Zona e plazhit dhe fshati Velipojë. Në zonën e plazhit ka 6 stacione pompimi. Sistemi i kanalizimeve të Velipojës ka 45 km tubacione betoni dhe HDPE me dimension DN 160 mm dhe DN 250 mm dhe afërsisht 200 puseta dhe 11 stacione pompimi.

- Sistemi kanalizimeve i fshatit Shirokë u ndërtua në vitin 2015 dhe mbulon 90% të zonës. Ujërat e ndotura dërgohen në stacionin e pompimit dhe në tubacionin kryesor të ITUN të Shirokës. Nga aty pasi trajtohen, derdhen në liqenin e Shkodrës

- Rrjeti i kanalizimeve të fshatit Shirokë përfshirë kolektorin kryesor përmbledh afërsisht 7-8 km tubacione HDPE me dimension DN 160 mm - DN 250 mm. Në sistem ka edhe rreth 200 puseta.

- Asnjë nga fshatrat e tjera në njësitë administrative të bashkisë Shkodër nuk ka sisteme kanalizimi. Për rrjedhojë, banorët përdorin gropa septike të ndërtuar individualisht që shpesh nuk plotësojnë standardet e kërkuara teknike.

Disa prej zonave kryesore që nuk kanë shërbime të grumbullimit të ujërave të ndotura përfshijnë zonat industriale, zonat informale në lindje, pjesa veriore dhe lindore e qytetit dhe zona jugore kodrinore e Kalasë së Rozafës. Disa prej ndërtimeve që ndodhen në zonën e shërbimit nuk janë lidhur ende në sistemin e kanalizimeve.

Probleme të tjera të rrjetit të kanalizimeve rrjedhin prej mungesës së kapaciteteve të pusetave (zakonisht vidhen), ndërtimet ilegale gjatë 20 viteve të fundit mbi kolektorët dhe hedhjes së mbetjeve në puseta. Kjo shkakton shkatërrimin e sistemit, bllokimin dhe një sërë problemesh operacionale.

1.2.2 Sistemet e kanalizimit të ujërave të shiut në Bashkinë Shkodër

Sistemi kullues i ujërave të shiut, u ndërtua fillimisht si një sistem i veçantë nga rrjeti i kanalizimeve. Shkodra ka një sistem largimi të ujërave të shiut sipas një sistemi kanalesh të hapura, tombina dhe tubacione ku pjesa më e madhe e ujit të shiut shkarkohet me gravitet në Liqenin e Shkodrës, ndërsa disa zona, duke përfshirë edhe zonën industriale, shkarkohen në lumin Kir.

Gjatësia e përgjithshme e sistemit të kanalizimeve është rreth 54 km nga të cilat rreth 37 km janë tubacione, tombina dhe kanale të hapura në gjendje të mirë nga ana hidraulike, dhe pjesa tjetër prej 17 km përbëhet nga kanale në gjendje jo të mirë me karakteristika percjellje

prurje jo te mira. Përveç kësaj, ka dhe shumë kilometra me kanale të vogla kullimit. Me kalimin e viteve, me rrjetin e kanalizimeve te ujrave te zeza janë lidhur shumë lidhje te ujërave të shiut dhe kjo çon në përmytjeve të disa zona gjatë shirave te furishem. Rreziqet shëndetësore në këte shtuate janë shumë evidente.

1.2.3 Impiante të trajtimit të ujërave të ndotura

Qyteti Shkodër nuk ka ITUN; ujërat e ndotura të patrajtuara pompohen në derdhjen e lumit Drin. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së qytetit në zonën nën-urbane nuk është e lidhur në sistem dhe për pasojë shkarkimet bëhen në gropa septike private.

1.2.3.1 ITUN SHIROKE

Impianti I Trajtimit të Ujërave të Ndotura Shirokë është ndertuar në kuadër të projektit “Furnizimi me Ujë dhe Mbrojtja Ambientale e Liqenit të Shkodrës”, me një sipërfaqe prej 1913 m, I cili trajton ujërat e ndotura të Shirokës e cila është një lagje e qytetit të Shkodrës me vendndodhje buzë Liqenit të Shkodrës dhe larg qendrave të banuara. Është projektuar i tillë që në të ardhmen të trajtoje dhe ujërat e ndotura të Zogaj. Ka një kapacitet trajtimi prej 350m³/d. përkatësisht për 2000 popullsi ekuivalente.

Teknologjia e trajtimit të ujit të ndotur është fizike dhe biologjike e avancuar, njësitë operacionale në të cilat kalon uji i ndotur dhe më pas llumi janë përkatësisht:

1. Grilat automatike
 2. Baseni I ajrimit
 3. Sedimentuesi
 4. Trashuesi I llumit
 5. Shtreterit e tharjes se llumit
- **Paratrajtimi mekanik (fizik)**

Nëpërmjet stacionit të pompave që ndodhet në qendër të Shirokës uji I ndotur sillet në impiant për t`u trajtuar. Njësia operacionale e para trajtimit të ujit është një njësi kompakte që përfshin grila automatike fi në (me hapësire ndërmjet shufrave 3 mm) me rërëmbledhës cilindrik dhe yndyrmbledhës dhe largimin e elementeve FOG (fat, oil, and grease), të gjitha këto brenda një njësie të vetme .

Ky trajtim fizik I automatizuar ka shumë rëndësi duke qënë se pastron influentin duke larguar papastërtitë e një madhësie të konsiderueshme, dhe gjithashtu eviton bllokimin e njësive operacionale të mëtejshme. Trajtimi në këtë njësi mundëson largimin e rërës në masën 90%.

- **Trajtimi Biologjik - Baseni I ajrimit**

Uji I ndotur I trajtuar vetëm fizikisht në njësinë e paratrajtimit do I nënshtrohet një trajtimi biologjik me llum aktiv në basenin e ajrimit. I gjithë procesi në basenin e ajrimit ndahet në dy proces perioda:

1- Nitrifikimi, kur injektohet ajër nga pjesa e poshtme drejt sipërfaqes së basenit, pra ka vetëm furnizim me ajër gjë që përkon me trajtim aerobik.

2- Denitrifikimi, kur fiket injektimi I ajrit dhe automatiksht ndizet mikseri I llumit, gjë që përkon me një trajtim anaerobik të llumit.

Të dy proces periodat përbëjnë një cikël të vetëm. Pra brenda një baseni, arrihet një trajtim aerobik dhe anaerobik.

Një avantazh I alternimit të dy periodave, të oksigjenimit dhe të periudhes pa oksigjen (zone anoksie) është reduktimi pjesor i fosforit P. Gjatë periudhës së anoksisë nitratet janë reduktuar dhe nuk ka me O₂ të mbetur. Bakteriet I merr “uria” dhe kur fryrësat e ajrit ndizen përsëri marrja apo thithja e fosforit është më e madhe se zakonisht me metabolizmin e bakterieve.

Në basenin e ajrimit trajtimi I ujit të ndotur do të bazohet në parimet e mëposhtme:

- Largimi I karbonit
- Nitrifikimi – shndërrimi i Amoniakut në nitrate
- Denitrifikimin e nitrateve të prodhuara gjatë nitrifi kimi
- Reduktimi pjesor i Fosforit (P)

Artificialisht bakteriet mbahen në basen nga:

- Injektimi i O₂ me fryresa ajri nga poshtë drejt siperfaqes
- Sigurimin me ushqim për bakteriet nga uji që qarkullon
- Mbajtja e një biomase të bollshme nga riciklimi I llumit aktiv që është në sedimentues

“Likuidi I miksuar” kalon nga baseni I ajrimit për tek sedimentuesi me gravitet nëpërmjet një tubacioni. Sedimentuesi është dizenuar për të siguruar një rrjedhje vertikale me llum të sedimentuar dhe ujë të klarifikuar duke u ngritur shumë ngadalë drejt sipërfaqes. Uji i klarifikuar (efluenti) nxirret nëpërmjet tubave nga sedimentuesi, I cili më pas shkarkohet në liqenin e Shkodrës. Efluenti më pas kalon në një dhomëz për matjen e prurjes , ku një IDM (induksion magnetik për matjen e prurjes) shënon sasinë e ujit që shkarkohet nëpërmjet një tubacioni 200mm Ø në liqenin e Shkodrës.

• Trajtimi i Llumit

Përveç 30% e llumit aktiv i cili riqarkullohet (me anë të pompave) për të realizuar trajtimin biologjik, kemi prezencën e llumit të tepërt i cili duhet trajtuar. Për këtë gjë është projektuar Trashuesi i llumit, ky proces trajtimi llumi realizohet me gravitet dhe pasohet me Shtretërit e Tharjes së llumit 12 shtreter gjithsej.

Procesi i tharjes së llumit realizohet natyralisht me anë të evapo transpirimit dhe kullimit të ujit të tepërt të llumit. Pjesa nëntokësore e secilit shtrat tharje është e pajisur me shtresë rënore dhe gjeomembrane dhe me tubacione me vrima përgjatë gjithë seksionit të shtratit , në mënyrë të tillë që uji që kullon nga llumi i trashuar të mblidhet dhe të rifutet në basenin e ajrimit për trajtim. Përqëndrimi i lëndës së thatë (DS) në shtretërit e tharjes do jetë 20-40 % .

1.2.3.2 ITUN VELIPOJE

Impianti i trajtimit të Ujërave të Ndotura i Velipojes, është i vendosur në një kodër të vogël rreth 12 m mbi nivelin e detit, 3 km larg nga zona bregdetare dhe rreth 1,5 km larg nga fshati Velipojë.

Zona e Velipojës ndahet në 10 qendra të banuara në një territor rreth 6400 ha, ku secila prej tyre është e përqendruar rreth qendrës së banuar.

Projektimi i impiantit të Velipojës ka marrë në konsideratë popullsinë e përhershme dhe atë sezonale/ turistike. Popullsia e përhershme është rreth 10.000 banorë, ndërsa ajo sezonale parashikohet rreth 90.000 banorë.

• Teknologjia e trajtimit të ujërave të ndotura urbane

Paratrajtimi mekanik

Trajtimi sekondar

Trajtimi terciar

Trajtimi i llumit

o paratrajtimi mekanik

Prurjet në impiant gjatë dimrit shkojnë rreth 65m³/ore, ndërsa në verë rreth 390m³/orë.

Gjatë paratrajtimit bëhet trajtimi fizik i ujërave të ndotura, gjatë së cilit eliminohet një sasi e konsiderueshme e lëndës së ngurte, gjithashtu evitohet bllokimi i njësive operacionale të mëtejshme.

Tek njësia e parë në hyrje është kanali i qetësimit i pasuar nga grilat, rërëmbledhësi, yndyrmbledhësi, ku këto dy të fundit konsiderohen si nivel i parë i trajtimit dhe të dy proceset realizohen në një njësi trajtimi të vetme.

oTrajtimi sekondar

Niveli sekondar i trajtimit realizohet nëpërmjet baseneve paralele të tipit SBR, që supozon kalimin e njëpasnjëshëm të proceseve si ai i mbushjes, procesi ku ndodhin reaksione në kushte anaerobe dhe aerobe, sedimentimi ose qetësimi, dekantimi ku ndahet plotësisht uji nga llumi dhe mbi llumin e tharë rifillon mbushja me effluent për të nisur sërish ciklin e trajtimit në nivel sekondar.

oTrajtimi terciar

Në fund uji i trajtuar kalon në njësine të tretësore të trajtimit, që është ajo e desinfektimit me reze UV.

Energjia e UV shkatërron menjëherë materialin gjenetik të mikro-organizmave, duke eliminuar mundësinë e riprodhimit dhe shkaktimit të infeksioneve.

Pas këtij procesi uji i trajtuar është gati për t'u shkarkuar në lumin Buna.

oTrajtimi i llumit

Llumi i gjeneruar nga proceset e trajtimit futet në basenin e trashjes së llumit.

Pasi trashet llumi kalon në basenin e qetësimit / ekuilibrimit.

Pas qendrimit në basenin e qetësimit llumi i nënshtrohet trajtimit final.

Trajtimi final konsiston në ndarjen e ujit nga llumi nëpërmjet dy centrifugave paralel të cilave u shtohet polielektrolit për një ndarje sa më efikase të ujit nga llumi.

Për klientët që përdorin gropa septike individuale nuk bëhet trajtim të ujërave të ndotura.

1.3 Investimet e viteve të fundit në sistemet e shpërndarjes

Shkalla e lartë e amortizimit të rrjetit të ujësjellësit e rrit më shumë nevojën për riparime dhe zëvendësime kapitale të rrjetit për të përmirësuar dhe mbajtur cilësinë e shërbimeve duke siguruar mirëmbajtjen e aseteve dhe menaxhuar kostot e riparimeve dhe zëvendësimeve edhe në të ardhmen. Bashkia Shkodër gjatë viteve 2015-2022 ka investuar në rikonstruksionin e rrugëve dhe rrugicave të lagjeve të qytetit dhe njësive administrative duke përfshirë në këto projekte edhe zëvendësimin e linjave të amortizuara të ujit, KUZ dhe KUB, paralelisht shoqëria ka vazhduar me instalimin e matësave të ujit tek klientët.

Më poshtë rendisim rrugët në të cilat është ndërhyrë me punë rehabilitimi/ apo zëvendësuar të rrjetit të furnizimit me ujë të popullsisë, si dhe një pasqyre të investimeve të kryera nga bashkia Shkodër gjatë viteve të fundit.

Tabela 3 Investimet e realizuara nga Bashkia Shkodër

Nr.	Financimi	Emertimi	Sektori
1	Bashkia Shkoder	Sistemim,asfaltim rruga Myzyraj	Kub
2	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruge te brendshme Shiroke, Rikonstruksion rruga Ernest Koliqi	Kub
3	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion blloqe pallatesh Bul.Mehmet P.Plaku	KUZ, KUB
4	Bashkia Shkoder	Rehabilitim I qendres se fshatit Shtoj I Ri	Kub
5	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga Ymer Prizreni	Kub,Kuz, ujesjelles
6	Bashkia Shkoder	Rikualifikimi urban blloqe banimi Lek Dukagjini (tek rajoni 2)	Kub, Kuz, ujesjelles
7	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruge dytesore Lagja nr.1	Kub,Kuz, ujesjelles

8	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga Rexhep Dizdari	Kub,Kuz, ujesjelles
9	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga "Imzot Zef Simoni"	Kub,Kuz, ujesjelles
10	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga e Korpusit	Kub,Kuz, ujesjelles
11	Bashkia Shkoder	Rikualifikim blloqe banimi Europa	Kub,Kuz, ujesjelles
12	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion blloqe pallatesh Bul.Mehmet P.Plaku (perballe shkolles Ali Laçej)	Kub,Kuz, ujesjelles
13	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion blloqe pallatesh Bul.Mehmet P.Plaku (perballe Medreses)	Kub,Kuz, ujesjelles
14	Bashkia Shkoder	Sistemim,asfaltim te brendshme fshati Fshati Reç I Ri	Kub, Kuz, ujesjelles
15	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga Safet Hoxha	Kub
16	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga Gjon Shllaku	Kub,Kuz, ujesjelles
17	Bashkia Shkoder	Rikualifikim urban Blloqe banimi rruga Levizja e Postribes	Kub,Kuz,
18	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga e Myzyrit	Kub,Kuz, ujesjelles
19	Bashkia Shkoder	Rikualifikim urban Blloqe banimi "Shtate Shaljanet"	Kub
20	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga Mehmet Shpendi	Kub,Kuz
21	Bashkia Shkoder	Ndertim trotuari Bahçallek	Kub
22	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga I qershori	Kub,Kuz, ujesjelles
23	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga Paqes dhe Besa Shqiptare	Kub,Kuz, ujesjelles
24	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga Ibrahim Rugova	Kub,Kuz
25	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion blloku i pallateve Osja i falltores(krahu i majte)	Kub,Kuz, ujesjelles
26	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga Magjoni	Kub,Kuz, ujesjelles
27	Bashkia Shkoder	Rikualifikim urban blloqe banimi Lek Dukagjini (ish vajguri)	Kub,Kuz, ujesjelles
28	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion degezim rruga At Gjergj Fishta	Kub
29	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion degezim rruga "Marin Biçikemi"	Kub,Kuz, ujesjelles
30	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion degezim rruga "Pogej"	Kub,Kuz
31	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga Degrand	Kub,Kuz, ujesjelles
32	Bashkia Shkoder	Rik.blloqe banimi "Europa " ish Podgorica	Kub,Kuz, ujesjelles
33	Bashkia Shkoder	Rruga Cen Broja	Kub,Kuz, ujesjelles
34	Bashkia Shkoder	Kamilo Libardi	Kub, ujesjelles
35	Bashkia Shkoder	Qazim Hoxha	Kub,Kuz, ujesjelles
36	Bashkia Shkoder	Hamit Gjylbegu	Kub,Kuz, ujesjelles
37	Bashkia Shkoder	Henrik Laca	Kub,Kuz
38	Bashkia Shkoder	Rruga Shasit	Kub,Kuz, ujesjelles
39	Bashkia Shkoder	Rruga Brioti	Kub, ujesjelles

40	Bashkia Shkoder	Rruga Zabelej	Kub
41	Bashkia Shkoder	Rikualifikim Urban Blloqe banimi "Qemal Draçini" (Pallati i Pyjores)	Kub, ujesjelles
42	Bashkia Shkoder	Trotuari Gomsiqe	Kub, ujesjelles
43	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion Rrugë Velipojë Plazh	Kub,Kuz, ujesjelles
44	Bashkia Shkoder	Rik. rruga "Vllaznimi"	Kub,Kuz, ujesjelles
45	Bashkia Shkoder	Ujesjellesi Mark Lula	Kub
46	Bashkia Shkoder	Rik.rruga Malesoret e Mullirit	Kub
47	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga "Udhakryq"	Kub, Kuz
48	Bashkia Shkoder	Sistemim,asfaltim, rruga Berdice e Siperme	Kub
49	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion rruga Zef Kakarriqi	Kub, Kuz, Ujesjelles
50	Bashkia Shkoder	Rruga Mukej	Kub, Kuz, Ujesjelles
51	Bashkia Shkoder	Rruga degezim I Shirokes	Kub, Kuz, Ujesjelles
52	Bashkia Shkoder	Rruga Hafiz Ali Ulqinaku	Kub, Kuz, Ujesjelles
53	Bashkia Shkoder	Rruga Hamidije Shtoj I Vjeter	Kub, Kuz, Ujesjelles
54	Bashkia Shkoder	Rruga Nacionale Ada-By Pass	Kub, Kuz, Ujesjelles
55	Bashkia Shkoder	Rruga Myzyraj Dobraç	Kub, Kuz, Ujesjelles
56	Bashkia Shkoder	Rruge te brenshme Guri I Zi	Kub, Kuz, Ujesjelles
57	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion Rruga Daut Boriçi	Kub, Kuz, Ujesjelles
58	Bashkia Shkoder	Lidhja e linjave te KUB,KUZ,Ujesjelles rruga Zef Kakarriqi	Kub, Kuz, Ujesjelles
59	Bashkia Shkodër	Ndërtim Stacion Pompimi dhe rrjeti Ujësjiellësit Kullaj	Ujësjiellës

Në vitin 2019 Bashkia Shkodër ka nënshruar procesverbalin për mbështetjen që agjensitë; Bashkepunimi Financiar Gjerman, Bashkimi European dhe SECO do të realizojnë në fazën e parë të mbështetjes në katër vitet e ardhshme, për Bashkinë Shkodër, shoqërinë UK Shkodër, në sistemin e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve.

Vlera e financimit dhe prioritarizimi i investimeve janë rrjedhojë e vlerësimit teknik që ekspertët e huaj kanë bërë për UK Shkodër, indikatorët e performancës në rritje, dhe objektivat e vënë si nevojave prioritare për investime.

- Komponenti i ujit (afërsisht 10 milion EURO). Rehabilitimi i rrjetit të ujësjiellësit në Qytetin e Shkodrës duke përfshirë krijimin e Zonave të Matura të Shërbimit (DMA) dhe lidhjeve në banesa në këto DMA; shtrirja e rrjetit të shpërndarjes së ujësjiellësit në Dobraç; Sistemi SCADA, pajisjet O&M.

- Komponenti i ujërave të ndotura (afërsisht 9.5 milion Euro), konsiston në:

- o Ndërtimin e linjës së transmetimit kryesor në Impiantin e Trajtimin të Ujërave të Ndotura (WWTP); rehabilitimi i stacionit të pompimit.

- o Ndërtimi i një Impianti biologjik për Trajtimin e Ujërave të Ndotura WWTP (kapaciteti i fazës së parë është përafërsisht 50,000 PE) që përfshin lehtësira për trajtimin e llumit dhe pajisje për funksionimin e sigurt të shërbimeve të ujërave të ndotura për qytetin e Shkodrës.

1.4 Struktura Organizative

Struktura organizative e kompanisë bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 9901/2008 “Mbi tregtarët dhe kompanitë Tregtare” i ndryshuar, përgjegjësitë e saj përcaktohen në statutin e kompanisë, i cili gjithashtu bazohet në të njëjtin ligj.

Statuti i UK përcakton sistemin e organizimit me dy nivele administrimi të përbërë nga organet e mëposhtëm:

1. Asamblea e Përgjithshme
2. Këshilli Mbikqyrës

Administratori

Drejtoritë Operacionale dhe sektorët

Siç përcaktohet në statut, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe shitja te klientët.
- Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për të plotësuar kërkesën e klientëve për ujë.
- Mirëmbajtja e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm.
- Grumbullimi, heqja dhe trajtimi i ujërave të ndotura.
- Mirëmbajtja e sistemit të kanalizimeve dhe njësisë të trajtimit.
- Mirëmbajtja e sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut.

Për të përmbushur këto detyra të saksionuara në statutin e saj shoqëria është e organizuar si më poshtë:

Përbërja hierarkike e UKRSH përmban 4 nivele:

1. Këshilli Mbikqyrës
 2. Administratori i Përgjithshëm – Drejtorin Ekzekutiv;
 3. Departamentet dhe Drejtoritë e ndryshme dhe
 4. Sektorët (që përbëjnë çdo Drejtor)
- o Departamenti Tregtar
 - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
 - o Sektori I Financës
 - o Sektori I Planifikimit dhe raportimit
 - o Sektori IT
 - o Sektori Juridik
 - o Sektori I prokurimeve
 - o Sektori I burimeve mbështetëse
 - Drejtoria e Marrdhënieve me Klientët

- Sektori I kontratave dhe ankesave
- Sektori I faturimit
- Sektori I shitjeve
- Departamenti Teknik
 - Drejtoria e Prodhimit dhe Transmetimit të Ujit
 - Sektori I Prodhimit
 - Sektori Teknik
 - Sektori I Planifikimit/Monitorimit të projekteve dhe asetëve
 - Drejtoria e grumbullimit të Ujërave të ndotura
 - Sektori I përpunimit të ujërave të ndotura
 - Sektori Elektro-mekanik
 - Sektori I monitorimit të cilësisë së ujit/mjedisit dhe ITUN
 - Sektori KUB

Numri i miratuar i punonjësve për shoqërinë rajonale UK Shkodër për vitin 2024 është, 483 punonjës. Numri i lartë i stafit operativ diktohet nga mungesa e automatizimit të stacioneve të prodhimit të ujit dhe domosdoshmëria e komandimit manualisht të agregateve punues. Njësia Shkodër ka numrin më të madh të punonjësve rreth 68%, për arsye të numrit të madh të stacioneve të pompimit dhe zonës së shtrirë të shërbimit.

1.5 Zona e shërbimit

- **Mbulimi me shërbim**

Rajonalizimi i shoqërisë, duke e zgjeruar zonën e juridiksionit në kufinjtë e qarkut Shkodër, ndikoi rrënjësisht në treguesit e mbulimit me shërbim, duke e përkeqësuar atë.

Tabela 4 Të dhëna për popullsinë dhe zonën e shërbyer

	Shkodër	Rajonale
Zona e shërbimit të popullsisë		
Totali	208,618	334,914
Urbane	115,215	135,592
Rurale	93,403	199,332
Popullsia e shërbyer me furnizimin me ujë		
Totali	120,898	173,970
Urbane	97,034	110,788
Rurale	23,864	63,182
Mbulimi me shërbimin e furnizimin me ujë		
Totali	58%	52%

Urbane	84%	82%
Rurale	26%	32%



Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Shkodër	
5 <u>Bashki</u>	
28 <u>Njësi</u> Administrative	
272 <u>Fshatra</u>	
<u>Siperfaqja e shërbimit</u> 3562 km ²	
<u>Popullsia në zonën e juridiksionit</u> 334,914 <u>banorë</u>	

Figurë 1 Zona e shërbimit

Vlerësohet se mbulimi me shërbim i zonës urbane të njësive Shkodër është rreth 84%, ndërsa i zonës rurale është 26%.

Nga këndvështrimi strukturor demografik në Bashkinë Shkodër banojnë rreth 62 % e popullsisë së qarkut Shkodër dhe dendësia mesatare e popullsisë së rajonit Shkodër është 230 banorë/km². Pjesa më e madhe e fshatrave nuk kanë mbulim me shërbimin e furnizimit me ujë, duke bërë të dukshme nevojën që kanë këto zona për investime kapitale në ndërtimin e rrjeteve të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Pjesa më e madhe e fshatrave nuk kanë mbulim me shërbimin e furnizimit me ujë, duke bërë të dukshme nevojën që kanë këto zona për investime kapitale në ndërtimin e rrjeteve të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

Problemi kryesor qëndron në ekzistencën e zonave të quajtura “të bardha”, të cilat nuk shërbehen nga shoqëria UKRSH. Kryesisht këto janë zonat informale të qytetit të cilat nuk kanë një rrjet shpërndarës, si dhe pjesa më e madhe e fshatrave. Niveli i ulët i mbulimit lidhet me mungesën e investimeve kapitale për zgjerimin e rrjetit të furnizimit. Investimet me të ardhurat e veta kushtëzohen nga pamundësia financiare e UKRSH për të realizuar investime kapitale me nivelin aktual të të ardhurave që gjeneron.


- **Numri i lidhjeve**

Numri i lidhjeve të shërbimit ka pasur rritje të vazhdueshme gjatë viteve të fundit, kjo lidhet me aksionet e realizuara nga grupet e terrenit, si detyrë funksionale e tyre për evidentimin e të gjitha lidhjeve të paligjshme dhe legalizimin e tyre.

Tabela 5 Numri i lidhjeve

Nr I lidhjeve	Shkodër	Rajonale
me mates	24448	33790
Aforfe	9138	11297
Totale	33586	45087

Rregullimi i marrëdhënies me klientët ka në thelb të saj pajisjen me ujëmatës. Në këtë drejtim shoqëria UKRSH ka angazhuar të gjitha kapacitetet e saj, duke arritur rritjen e vazhdueshme të pajisjes me matës të lidhjeve të konsumatorëve nga viti në vit, duke arritur në 73% në vitin 2023.



Figurë 2 % e lidhjeve me matës

Pajisja me ujëmatës i mundëson shoqërisë dy elemente shumë të rëndësishme:

- Një marrëdhënie më korrekte me klientët e saj, duke rritur ndërgjegjësimin për kursimin e ujit dhe duke paguar vetëm për atë sasi që konsumojnë.
- Si dhe mundësinë e një kontrolli më të madh mbi klientët e saj, kryesisht ata që nuk përmbushin detyrimet e tyre kundrejt shoqërisë rajonale UK Shkodër.

Përveç pajisjes me matës të rinj, shoqëria kujdeset edhe për zëvendësimin e matësave të dëmtuar, si dhe atyre që ju mbaron periudha e vlefshmërisë.

Objektivat e ardhshëm të shoqërisë në lidhje me nivelin e matjes, synojnë rritjen e mëtejshme të kësaj norme deri në arritjen 100% pajisje me matës të të gjithë klientëve, pasi ndikon drejtpërdrejtë në përmirsimin e performancën së shoqërisë rajonale UK Shkodër.

1.6 Plotësimi I kërkesave të VKM Nr. 23 dt, 09.01.2008 “Për tarifat e përdorimit të ujit”

Shoqëria rajonale UK Shkodër, në zbatim të VKM Nr. 23 dt. 09.01.2008 “Për tarifat e përdorimit të ujit”, ndryshuar me VKM Nr. 662, datë 21.9.2016, përmbush detyrimin e saj për pagesën ndaj agjensisë së baseneve ujore, të tarifave në lidhje me shfrytëzimin e rezervave ujore, qofshin këto sipërfaqësore, apo nëntokësore. Nga ana tjetër shtrojmë shqetësimin tonë në lidhje me përdorimin e burimeve ujorë nëntokësore me anë të pus-shpimeve private nga familjarë dhe ente private të ndryshme në qytetin e Shkodrës, si rrjedhojë e lehtësisë së arritjes së ujit të pijshëm falë terrenit dhe rezervave ujore nëntokësore që ka rajoni i Shkodrës. Shqetësim më të madh paraqesin ato raste ku rrjeti shpërndarës ekziston, por klientët mbajnë furnizim me ujë të dyfishtë duke rritur në këtë mënyrë rrezikun e kontaminimit të ujit të rrjetit të shpërndarjes si rrjedhojë e kalimit në rrjet të ujit të pus-shpimeve private. Ka edhe raste të tjera që kërkojnë të shkëpusin

marrëdhënien e furnizimit me shoqërisë rajonale UK Shkodër, për arsye të mos pasjes së presionit të mjaftueshëm, ashtu sikurse ka edhe zona të cilat janë të pashërbyera nga shoqëria rajonale UK Shkodër me furnizimin me ujë të pijshëm dhe për rrjedhojë në mungesë të investimeve publike, familjarët janë të detyruar të realizojnë skema private furnizimi me ujë. Në të gjitha rastet e furnizimit me ujë me pus-shpime private ekziston rreziku i shfaqjes së problemeve shendetësore të këtyre konsumatorëve, si rrjedhojë e konsumit të ujit të pakontrolluar, i cili mund të ketë ngarkesa mikrobike që mund të jenë të rrezikshme për shëndetin e tyre.

1.7 Efiçenca e energjisë

Energjia për prodhimin dhe pompimin e ujit të pijshëm si edhe ajo për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura është gjithashtu një është një zë shpenzimesh, që zë një pjesë të konsiderueshme në strukturën e kostos së shoqërisë rajonale UK Shkodër dhe shkon deri në afërsisht 31.3% e kostove të operim/mirëmbajtjes. Shoqëria rajonale UK Shkodër është e përkushtuar të rrisë efiçencën e përdorimit të energjisë për të mbajtur nën kontroll dhe zvogëluar këtë zë të rëndësishëm të shpenzimeve. Për të arritur këtë ne angazhohemi në zëvendësimin e pompave që dalin jashtë përdorimit me pompa me parametra teknik që kanë efiçencë më të lartë energjitike. Përdorimi i teknologjive të reja për shfrytëzimin e burimeve alternative për energjinë elektrike që konsumohet nga stacionet tona të operimit, është e vështirë, pasi nuk kemi burime të mjaftueshme kapitale për financimin e tyre. UKRSH mbetet e anagazhuar në rritjen e efiçencës së energjisë elektrike, duke optimizuar edhe kohën e operimit të agregatëve punues.

1.8 Gjendja e aseteve të shoqërisë rajonale ujësjellës Kanalizime Shkodër

Nga ana e shoqërisë rajonale UK Shkodër, menaxhimi i aseteve konsiderohet një çështje prioritare, për këtë arsye në organizimin e saj është krijuar një strukturë e posaçme, që ka detyrën e krijimit dhe mbajtjes së rregjistrave të saktë të aseteve të shoqërisë. Të dhënat për asetet e shoqërive të agreguara paraqiten në tabelën e mëposhtme. Nevoja për azhurmimin e listave të aseteve është prioritet, në ndihmë të realizimit të kësaj detyre të rëndësishme, shoqëria përdor sistemin e informacionit gjeografi (GIS), i cili mundëson rregjistrimin e tyre në një sistem të posatshëm informatik për të gjitha asetet e njërive të ndryshme.

Tabela 6 Asetet e UKRSH

Asetet	Mosh/Vlera 000/lek					
	Deri në 25 vjeçare		25-50 vjeçare		>50 vjeçare	
	%*	lek	%*	lek	%*	lek
Tubacione	30%	934,165	60%	1,868,330	10%	311,388
Ndërtesa	20%	215,033	70%	752,617	10%	107,517
Stacione pompimi, puse	56%	829,775	38%	563,061	6%	88,904
Makineri, pajisje	53%	43,611	38%	31,268	9%	7,406-
TOTALI		2,022,584		3,215,276		515,215

Rreth 80% e aktiveve të qëndrueshme i përkasin njësisë Shkodër. Asetet e njësisë Shkodër gjithashtu janë amortizuara dhe kanë nevoja të shumta për ndërhyrje riparuese të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes.

II. RELACIONI SHPJEGUES EKONOMIK QË MBËSHTET PROPOZIMIN PËR NDRYSHIM TË TARIFAVE TË SHËRBIMEVE UK PËR SHOQËRINË RAJONALË UJËSJELLËS KANALIZME SHKODËR

2.1 Situata e përgjithshme financiare e shoqërisë

Rajonalizimi i shoqërisë është shoqëruar me përkeqësim të situatës ekonomiko-financiare të shoqërisë, pasi shoqëritë e agreguara, të gjitha kanë vështirësi financiare dhe humbje të shumta operative. Në analizën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e agreguara të shoqërisë rajonale.

Njësia Shkodër zë peshën kryesore të kostove me rreth 75% të tyre dhe zërat kryesorë të kostos janë shpenzimet e personelit dhe të energjisë elektrike.

Në vitin 2023, kostot për personelin dhe energjinë zunë secili rreth 45% të Kostove Operacionale Direkte, pra vetëm këta dy zëra të kostos zunë rreth 90% të totalit të kostove operacionale. Shpenzimet e tjera për materiale dhe shërbimet të nevojshme për veprimtarinë e shoqërisë zënë 10% të shpenzimeve operative.

Për shoqërinë rajonale UK Shkodër, kostot e energjisë janë shumë të larta për arsye se sistemet e prodhimit janë më ngritje mekanike, të cilat konsumojnë sasi të medha të energjisë elektrike, por edhe sistemi i kanalizimeve dhe sidomos impianti i trajtimit të ujërave të ndotura përdorin sisteme pompimi që konsumojnë shumë energji. Eficienca energjetike është një indikator shumë i rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në koston e energjisë.

Edhe në vitet në vazhdim kostot e personelit dhe të energjisë elektrike, do të zënë peshën kryesore, pasi vihet re një tendencë për rritjen e kostove të pagës minimale, gjë e cila është reflektuar në parashikime për kosto personeli shumë më të larta se niveli aktual, ku paga mesatare aktuale e punonjësve llogaritet në nivelin 47.000 lek.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur kostot operative të sektorit të Ujësjellësit, të ndara sipas llojit të tyre. Është paraqitur gjithashtu parashikimi i shpenzimeve operative për tre vitet në vazhdim.

Tabela 7 Të Dhënat e Kostove të Shërbimit të Furnizimit me Ujë

Nr. Llog.	Emërtimi	Viti 2023 (000/lekë)	Periodha Rregullatore		
			Viti 2025 (000/lekë)	Viti 2026 (000/lekë)	Viti 2027 (000/lekë)
60	Shpenzime Materiale	177.130,9	188.128,7	191.504,0	196.991,7
	Materiale	9.591,2	6.834,6	6.708,8	6.525,4
	Dezinfektimi	9.591,2	6.834,6	6.708,8	6.525,4
	Koagulant	0,0	0,0	0,0	0,0
	Flokulant	0,0	0,0	0,0	0,0
	Laboratori	0,0	0,0	0,0	0,0
	Energji elektrike për	150.599,3	153.437,5	155.779,8	158.333,2
	Karburantet dhe	2.706,0	3.840,6	4.194,6	4.564,9
	Për nevoja	0,0	0,0	0,0	0,0
	Për mjete transporti	2.706,0	3.840,6	4.194,6	4.564,9
	Veshje pune	0,0	1.500,0	1.575,0	1.653,8
	Furnizime zyre	0,0	2.727,6	2.863,8	2.921,1
	Materialet e punimeve	14.234,4	19.788,3	20.382,0	22.993,4
61	Shërbime nga të	15.344,2	35.343,0	36.495,6	37.690,9
	Siguracione	596,3	550,0	577,5	606,4
	Furnizimi me ujë me	0,0	0,0	0,0	0,0
	Qiratë, përfshirë	185,0	840,0	840,0	840,0
	Shërbimet postare dhe	266,5	855,6	898,4	943,3
	Shërbimet e	0,0	388,9	408,4	428,8
	Shërbimet (ujë,	0,0	252,0	264,6	277,9
	Publikime	0,0	311,1	326,7	343,0
	Konsulencë	1.775,3	8.844,1	9.140,5	9.447,4
	Ligjore	0,0	0,0	0,0	0,0
	Financiare,	1.775,3	1.555,7	1.633,5	1.715,1
	Teknike	0,0	0,0	0,0	0,0
	Të tjera (ju lutemi	0,0	7.288,4	7.507,0	7.732,3
	Roje sigurie dhe	8.884,2	17.500,0	18.025,0	18.565,8
	Agjenci per	0,0	0,0	0,0	0,0
	Shpenzime gjyqësore	0,0	0,0	0,0	0,0
	Testimi i matësit	0,0	0,0	0,0	0,0
	Testimi në laborator	0,0	0,0	0,0	0,0
	Trajnimet e personelit	0,0	700,1	735,1	771,8
	Punime të jashtme	932,0	1.756,4	1.767,4	1.779,0
	Depozitimi i llumit të				
	Shfrytëzimi i llumit të				
	Të tjera (ju lutemi	2.705,0	3.344,7	3.512,0	3.687,6
	Keshilli Mbikqyres	1.984,0	1.944,6	2.041,8	2.143,9
	Monitorim i cilesise	721,0	1.400,1	1.470,1	1.543,6
64	Shpenzime për	187.569,4	250.899,2	252.099,5	252.601,0
	Pagat e punonjësve	932,0	0,0	0,0	0,0
	Pagat për punime	0,0	0,0	0,0	0,0
	Pagesat e kontratave	932,0	0,0	0,0	0,0
	Pagesat e sigurimeve shoqërore për	31.324,1	43.343,8	43.472,2	43.469,6
	Pagesat e sigurimeve shoqërore për punimet	0,0	0,0	0,0	0,0

	Shpenzimet për dieta ushqimore dhe	0,0	1.443,6	1.371,6	1.285,2
63	Taksa dhe Tatime (4)	0,0	4.866,9	5.110,3	5.365,8
	Taksat dhe tarifrat		544,5	571,7	600,3
	Pagesa Rregullatore		2.722,5	2.858,6	3.001,5
	Pagesa per		1.600,0	1.680,0	1.764,0
	Pagesa per shkarkimin		933,4	980,1	1.029,1
	Të tjera (ju lutemi	633,5	933,4	980,1	1.029,1
	Shukalb, Taksa	0,0	0,0	0,0	0,0
	Shpenzime të tjera	122,3	388,0	407,4	427,8
	Dieta	0,0	0,0	0,0	0,0
	Siguria në punë	0,0	388,0	407,4	427,8
	Shpenzime udhëtimi	122,3	0,0	0,0	0,0
	Udhëtime Biznesi	0,0	0,0	0,0	0,0
	Bursa	0,0	0,0	0,0	0,0
	Të tjera (ju lutemi	0,0	0,0	0,0	0,0
	KOSTOT	411.490,8	522.969,6	529.089,0	536.546,8
68	Zhvlerësime dhe	151,363	149,849	148,350	146,867
	Shpenzim amortizimi				
	Amortizimet e				
	Provizioni/Shlyerjet e				
66	Interesat (7)	0	0	0	0
	Pagesat e Kredive				
	Interesat e kredive				
	Totali i Kostove te				
	KOSTO TOTALE	562.853,8	672.818,6	677.439,0	683.413,8

Kostoja e shërbimit të furnizimi me ujë parashikohet të rritet në vitet e ardhshme, kryesisht në zërin e shpenzime për personelin, si dhe kostot e mirëmbajtjes. Rritja e shpenzimeve të personelit është rezultante e efektit që do të ketë rritja e pagës minimale e cila do të reflektohet edhe në nivelin e pagave të specialistëve. Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve parashikohen në rritje dhe duhet të arrijnë nivelin prej 10 euro për lidhje në vit, me qëllim që të përmbushen objektivat e vendosura nga për projektin e investimeve MIPV. Gjithashtu edhe shpenzimet e tjera parashikohen në rritje, kjo për të reflektuar nevojën reale që ka shoqëria në respektim të dispozitave ligjore për të realizuar këto shpenzime.

Tabela 8 Të Dhënat e Kostove të Shërbimit të Kanalizimeve

Nr. Llog.	Emërtimi	Viti 2023 (000/lekë)	Periudha Rregullatore		
			Viti 2025 (000/lekë)	Viti 2026 (000/lekë)	Viti 2027 (000/lekë)
60	Shpenzime	7.451,9	11.820,7	12.767,6	13.843,1
	Materiale	106,0	216,0	226,8	238,1
	Dezinfektimi	106,0	216,0	226,8	238,1
	Koagulant	0,0	0,0	0,0	0,0
	Flokulant	0,0	0,0	0,0	0,0
	Laboratori	0,0	0,0	0,0	0,0

	Energji elektrike për	2.034,2	2.441,1	2.929,3	3.515,1
	Karburantet dhe	1.584,0	2.890,6	3.151,2	3.436,3
	Për nevoja	0,0	0,0	0,0	0,0
	Për mjete transporti	1.584,0	2.890,6	3.151,2	3.436,3
	Veshje pune	0,0	334,5	351,2	368,8
	Furnizime zyre	0,0	755,9	771,0	786,4
	Materialet e	3.727,7	5.182,6	5.338,1	5.498,2
61	Shërbime nga të	3.119,6	9.685,4	9.992,0	10.310,7
	Siguracione	173,8	230,0	241,5	253,6
	Furnizimi me ujë me				
	Qiratë, përfshirë	0,0	360,0	360,0	360,0
	Shërbimet postare	0,0	174,5	183,2	192,4
	Shërbimet e	0,0	196,3	206,1	216,4
	Shërbimet (ujë,	0,0	66,0	69,3	72,8
	Publikime	0,0	157,0	164,9	173,1
	Konsulencë	460,7	2.693,9	2.790,4	2.890,6
	Ligjore	0,0	0,0	0,0	0,0
	Financiare,	460,7	785,1	824,3	865,5
	Teknike	0,0	0,0	0,0	0,0
	Të tjera (ju lutemi	0,0	1.908,8	1.966,1	2.025,1
	Roje sigurie dhe	2.224,1	3.650,0	3.759,5	3.872,3
	Agjenci per	0,0	0,0	0,0	0,0
	Shpenzime gjyqësore	0,0	0,0	0,0	0,0
	Testimi i matësit	0,0	0,0	0,0	0,0
	Testimi në laborator	0,0	0,0	0,0	0,0
	Trajnimet e	0,0	183,3	192,5	202,1
	Punime të jashtme	0,0	1.098,4	1.104,8	1.111,6
	Depozitimi i llumit të	0,0	0,0	0,0	0,0
	Shfrytëzimi i llumit	0,0	0,0	0,0	0,0
	Të tjera (ju lutemi	261,0	876,0	919,8	965,8
	Keshilli Mbikqyres	192,0	509,3	534,8	561,5
	Monitorim l cilesise	69,0	366,7	385,0	404,3
64	Shpenzime për	46.158,1	63.687,8	64.502,6	65.977,5
	Pagat e punonjësve	0,0	0,0	0,0	0,0
	Pagat për punime	0,0	0,0	0,0	0,0
	Pagesat e kontratave	0,0	0,0	0,0	0,0
	Pagesat e sigurimeve shoqërore për	7.708,4	10.815,9	10.951,9	11.198,2
	Pagesat e sigurimeve shoqërore për	0,0	0,0	0,0	0,0
	Shpenzimet për dieta ushqimore dhe	0,0	180,0	180,0	180,0
63	Taksa dhe Tatime	210,8	855,6	898,4	943,3
	Taksat dhe tarifrat	0,0	142,6	149,7	157,2
	Pagesa Rregullatore	210,8	713,0	748,7	786,1
	Pagesa për				
	Pagesa për	0,0	0,0	0,0	0,0
	Të tjera (ju lutemi	167,0	244,5	256,7	269,5
	Shpenzime të tjera	31,0	110,7	114,5	118,4
	Dieta	0,0	0,0	0,0	0,0
	Siguria në punë	0,0	110,7	114,5	118,4
	Shpenzime udhëtimi	31,0	0,0	0,0	0,0
	Udhëtime Biznesi	0,0	0,0	0,0	0,0
	Bursa	0,0	0,0	0,0	0,0
	Të tjera (ju lutemi	0,0	0,0	0,0	0,0

	KOSTOT	64.679,8	96.976,1	99.227,0	102.391,2
68	Zhvlerësime dhe	70,872	70,163	69,461	68,767
	Shpenzim amortizimi	0.0	0.0	0.0	0.0
	Amortizimet e	0.0	0	0	0
	Provizioni/Shlyerjet e	0	0.0	0.0	0.0
66	Interesat (7)	0.0	0.0	0.0	0.0
	Pagesat e Kredive	0.0	0.0	0.0	0.0
	Interesat e kredive	0.0	0.0	0.0	0.0
	Totali i Kostove te	0.0	0.0	0.0	0.0
	KOSTO TOTALE	135.551,8	167.139,1	168.688,0	171.158,2

Tabela 9 Të Dhënat e Kostove të Shërbimit të ITUN

Nr. Llog.	Emërtimi	Viti 2023 (000/lekë)	Periudha Rregullatore		
			Viti 2025 (000/lekë)	Viti 2026 (000/lekë)	Viti 2027 (000/lekë)
60	Shpenzime	4.802,8	6.832,0	7.914,0	9.199,8
	Materiale	0,0	837,0	878,9	922,8
	Dezinfektimi				
	Koagulant				
	Flokulant				
	Laboratori		837,0	878,9	922,8
	Energji elektrike për	4.165,3	4.998,4	5.998,0	7.197,7
	Karburantet dhe	300,0	414,7	435,4	457,2
	Për nevoja				
	Për mjete transporti	300,0	414,7	435,4	457,2
	Veshje pune		63,0	66,2	69,5
	Furnizime zyre		49,8	52,3	54,9
	Materialet e	337,5	469,2	483,2	497,7
61	Shërbime nga të	1.232,2	3.053,5	3.144,7	3.239,0
	Siguracione		22,0	23,1	24,3
	Furnizimi me ujë me				
	Qiratë, përfshirë				
	Shërbimet postare		20,3	21,3	22,4
	Shërbimet e		9,2	9,7	10,2
	Shërbimet (ujë,		6,0	6,3	6,6
	Publikime		7,4	7,7	8,1
	Konsulencë	142,0	209,7	216,7	224,0
	Ligjore				
	Financiare,	142,0	36,9	38,7	40,7
	Teknike				
	Të tjera (ju lutemi		172,8	178,0	183,3
	Roje sigurie dhe	1.057,2	2.500,0	2.575,0	2.652,3
	Agjenci per				
	Shpenzime				
	Testimi i matësit				
	Testimi në laborator				
	Trajnimet e		16,6	17,4	18,3
	Punime të jashtme		183,0	184,2	185,5
	Depozitimi i llumit				
	Shfrytëzimi i llumit				
	Të tjera (ju lutemi	33,0	79,3	83,3	87,4

	Keshilli Mbikqyres	24,0	46,1	48,4	50,8
	Monitorim I cilesise				
64	Shpenzime për	17.320,9	23.910,2	24.290,9	24.837,0
	Pagat e punonjësve	0,0	0,0	0,0	0,0
	Pagat për punime				
	Pagesat e kontratave				
	Pagesat e sigurimeve	2.892,6	4.072,2	4.135,8	4.227,0
	Pagesat e sigurimeve				
	Shpenzimet për dieta ushqimore dhe		79,2	79,2	79,2
63	Taksa dhe Tatime	107,5	77,5	81,3	85,4
	Taksat dhe tarifrat		12,9	13,6	14,2
	Pagesa Rregullatore	107,5	64,5	67,8	71,2
	Pagesa për				
	Pagesa për				
	Të tjera (ju lutemi	85,0	0,0	0,0	0,0
	Shpenzime të tjera	9,8	9,5	10,0	10,5
	Dieta				
	Siguria në punë		9,5	10,0	10,5
	Shpenzime udhëtimi	9,8			
	Udhëtime Biznesi				
	Bursa	0,0			
	Të tjera (ju lutemi	0,0			
	KOSTOT	26.365,8	37.954,9	39.576,7	41.598,5
68	Zhvlërësime dhe	56,505	56,223	55,942	55,662
	Shpenzim	0,0	0,0	0,0	0,0
	Amortizimet e	0,0	0	0	0
	Provizioni/Shlyerjet	0	0,0	0,0	0,0
66	Interesat (7)	0,0	0,0	0,0	0,0
	Pagesat e Kredive	0,0	0,0	0,0	0,0
	Interesat e kredive	0,0	0,0	0,0	0,0
	Totali i Kostove te	0,0	0,0	0,0	0,0
	KOSTOJTOTALE	82.870,8	94.177,9	95.518,7	97.260,5

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për numrin e klientëve, si dhe niveli i parashikuar i të ardhurave sipas llojit të shërbimit për shoqërinë rajonale. Pesha që zënë të ardhurat e gjeneruara nga ofrimi i shërbimit në njësinë Shkodër është në nivelin 75% të totalit të të ardhurave.

Rritja e nivelit të të ardhurave, përveçse me rritjen e tarifave lidhet edhe me rritjen e vëllimeve të shitura. Parashikimi për 3 vitet e ardhshme është bërë duke u bazuar në faktin e vitit 2022 dhe 2023, me përpjekjen për të qënë sa më të saktë në parashikim, nisur nga fakti që krijimi i shoqërisë rajonale të ujësjellësit është bërë pas gjysmës së vitit 2023. Rritja e volumeve të shitura të parashikuara bazohet në rritjen e kontrollit të terrenit nga grupet e strukturuara për realizimin e verifikimeve në të gjithë zonën e shërbimit. Edhe pse numri i lidhjeve të ujit është parashikuar në rritje, problem shqetësues për të ardhmen mbetet niveli i konsumit për lidhje, kjo e ndikuar nga numri shumë i lartë i lidhjeve me konsum zero. Ky fenomen është i lidhur me lëvizjet demografike të popullsisë, por edhe me burimet alternative që përdorin konsumatorët për furnizimin me ujë të banesave të tyre. Në Shkodër fenomeni i pus-shpimeve private është shumë i përhapur. Rritja e numrit të klientëve është

ë bazuar në investimin e bërë nga bashkia në Kullaj, si dhe investimi që parashikohet të realizohet nga projekti MIPV në fshatin Dobraq, duke ndërtuar rrjetin e shpërndarjes për furnizimin me ujë të kësaj zonë, me qëllim uljen e humbjeve përgjatë linjave kryesore të transmetimit, që shtrihen në këtë zonë.

Tabela 10 Të Dhënat për Klientët, Faturimin dhe të Ardhurat nga Aktiviteti i UK

Emërtimi	Njësia	Viti 2023		Periudha Rregullatore					
				Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		Klientë Familjarë	Klientë Jofamiljarë	Klientë Familjarë	Klientë Jofamiljarë	Klientë Familjarë	Klientë Jofamiljarë	Klientë Familjarë	Klientë Jofamiljarë
SHËRBIMI ME UJË TË PIJSHËM									
Numri i klientëve me matës	Nr.	29.958	3.832	36.565	4.586	39.146	4.701	41.757	4.819
Numri i klientëve pa matës	Nr.	10768	529	4991	0	2672	0	0	0
Sasia ujit të faturuar	000 m ³	4.083	798	4.392	821	4.416	852	4.514	863
Tarifa fikse	lek/muaj	200	300	200	300	200	300	200	300
Tarifa volumetrike	lek/m ³	40	110	70	140	70	140	70	140
Të Ardhurat nga Tarifa Fikse	000 lekë	51.835	5.625	99.735	16.511	100.363	16.924	100.218	17.347
Të Ardhurat nga Tarifa Volumetrike	000 lekë	162.252	89.621	296.960	105.069	298.916	110.459	305.720	113.590
SHITJA E UJIT ME SHUMICË									
Sasia ujit të faturuar	000 m ³								
Tarifa volumetrike	lek/m ³								
Të Ardhurat nga Shitja e Ujit me Shumicë	000 lekë								
SHËRBIMI ME KUN									
Numri i klientëve me matës dhe pa matës	Nr.	26.236	3.944	26.728	4.054	27.061	4.104	27.395	4.154
Sasia ujit të faturuar	000 m ³	2.682	681	2.774	702	2.852	714	2.905	736
Tarifa volumetrike	lek/m ³	15	20	40	50	40	50	40	50
Të Ardhurat nga Tarifa Volumetrike	000 lekë	38.511	12.943	106.182	34.715	108.788	34.854	110.515	36.017
Totali i të ardhurave	000 lekë	252.598	108.189	502.877	156.294	508.067	162.237	516.452	166.954

2.2 Llogaritja e nivelit të ri të tarifave për shërbimet që ofron shoqëria

Tarifimi i shërbimeve të ofruara nga shoqëria është realizuar mbi bazën e niveleve tarifore, që secila prej tyre kishte të miratuar. Tarifat aktuale të njësisë Shkodër janë në zbatim nga viti 2012 dhe janë në nivel aq të ulët saqë nuk arrijnë mbulimin e shpenzimeve operative, duke e vënë shoqërinë në vështirësi serioze për realizimin e misionit të saj. Njësia Shkodër ka tarifën më të ulët në nivel kombëtar të sektorit të ujit dhe nuk mbulojnë shpenzimet të cilat sidomos gjatë 3 viteve të fundit kanë njohur rritje të vazhdueshme në të

gjithë zërat e kostove. Më poshtë paraqitet një përmbledhje e tarifave që aplikohen aktualisht dhe niveli i ri që propozohet për vitet e ardhshme të periudhës rregullatore. Këto nivele janë rezultat i faktorëve të tarifës, të cilat llogariten nga formati i Modelit të Aplikimit në Excel sipas metodologjisë së tarifave të miratuar nga ERRU.

Tabela 11 Tarifave Aktuale dhe të Propozuara nga Shoqëria – Rajoni Shkodër

Kategoria e Klientëve	Zona e Shërbimit		Diferenca
	Tarifat Aktuale	Tarifat e Propozuara	
A. Shërbimi i FU	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³
1. Klientë Familjarë	40	70	30
2. Klientë Publik	110	140	30
3. Klientë Privat	110	140	30
B. Shërbimi i KUN	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³
1. Klientë Familjarë	15	40	25
2. Klientë Publik	20	50	30
3. Klientë Privat	20	50	30
C. Tarifë Fikse Shërbimi	Lek/muaj	Lek/m³	Lek/m³
1. Klientë Familjarë	100	200	100
2. Klientë Publik	100	300	200
3. Klientë Privat	100	300	200
D. Shitje Uji me Shumicë			
Shitje uji me shumicë UK			

2.3 Plotësimi i objektivave të mëparshme dhe synimi i objektivave të reja

Prioritete strategjike integrale të misionit të UKRSH janë si më poshtë:

- Objektiv i Strategjik 1: Reduktimi i ujit pa të ardhura.
- Objektiv i Strategjik 2: Përmirësimi i performancës financiare.
- Objektiv i Strategjik 3: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe mbulimi i shërbimeve.
- Objektiv i Strategjik 4: Përmirësimi i marrëdhënieve me konsumatorët.

Sipas secilit prej këtyre prioriteteve, UKRSH ka identifikuar objektiva dhe iniciativa për të drejtuar veprimtarinë e saj. Më poshtë paraqiten objektivat e synuar për vitin 2024.

Objektivi strategjik 1: Reduktimi i ujit pa të ardhura në 62%

UPA përfaqëson ujin që prodhohet, por nuk shitet, duke rritur kostot e prodhimit dhe duke kërcënuar qëndrueshmërinë operacionale dhe financiare të UKRSH. Objektivi është të zvogëlohet UPA, e shprehur si përqindje e vëllimit të prodhimit të sistemit, nga 67% aktuale në 2023 në 62% në vitin 2024. Në përgjithësi, zvogëlimi i ujit pa të ardhura, si në vëllimin total ashtu edhe në përqindje të totalit të ujit të prodhuar, kërkon reduktimin e humbjeve reale (teknike) dhe të dukshme (administrative). Humbjet teknike janë humbjet fizike që vijnë nga rrjedhjet në rrjetin e ujit. Humbjet administrative vijnë nga lidhjet/konsumi i paautorizuar dhe pasaktësitë e matësve.

Arritja e reduktimit të humbjeve nga 67% aktuale në një nivel prej 62% do të jetë e mundur përmes përpjekjeve të kombinuara në: a) instalimin e matësve, b) strategjisë së reduktimit sistematik të UPA-së, c) minimizimi i lidhjeve të paligjshme dhe d) reduktimin e numrit të lidhjeve me konsum zero. Instalimi i matësve të ujit në prodhim është shumë i rëndësishëm për monitorimin e prodhimit të ujit dhe shmangien e vlerësimit të sasisë së prodhuar të ujit.

Objektivi Strategjik 2: Përmirësimi i operacioneve financiare, duke arritur mbulimin e kostove operative në nivelin 78%.

Përmirësimi i operacioneve financiare për të mundësuar rritjen e të ardhurave për të rritur mbulimin e kostove të ofrimit të shërbimeve.

Përmirësimi i operacioneve financiare përfshin ndërmarrjen e veprimeve për të reduktuar kostot e drejtpërdrejta operacionale si dhe rritjen e të ardhurave.

Për të përmirësuar rezultatet financiare dhe për të rritur pavarësinë financiare dhe qëndrueshmërinë e kompanisë, parashikohen veprimet e mëposhtme:

- o Aplikimi për tarifa të reja gjatë vitit aktual për tarifatat e aplikueshme, në zbatim të vendimit të ERRU nr. 539, datë 30.12.2021, "Miratimi i Metodologjisë dhe Procedurave për Miratimin e Tarifave për Shërbimet e Ujësjellës Kanalizimeve".

- o Përmirësimi i situatës financiare duke rritur mbledhjen e të ardhurave në nivelin 105%.

- o Ulja e numrit të stafit administrativ plus personelin e furnizimit me ujë për 1000 lidhje .

Objektivi Strategjik 3: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar.

Ky objektivi strategjik synon rritjen e vazhdimësisë së furnizimit me ujë, aktualisht në nivelin 22orë /ditë, si dhe rritjen e mbulimit me shërbim dhe garantimin e cilësisë sipas standardeve, të shërbimit të ofruar të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

Objektivi Strategjik 4: Përmirësimi i marrëdhënieve me publikun (konsumatorët).

UKRSH do të përqëndrohet në përmirësimin e marrëdhënies me konsumatorët dhe do të përqëndrohet në ndërgjegjësimin, informimin e tyre, si dhe adresimin e ankesë/kërkesave të tyre.

Vitet e ardhshme parashikohen shumë sfiduese për shoqërinë në drejtim të përmirësimit të treguesve të saj të performancës dhe duke vendosur objektiva më sfidues për t'u arritur.

- Rritja e nivelit të mbulimit me shërbime për vitet e ardhshme parashikohet të arrijë nivelin 86% dhe 46%, përkatësisht për zonat rurale dhe urbane. Rritje parashikohet të arrihet në sajë të investimeve kapitale në zgjerimin e rrjeteve ekzistuese, por në rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar në zonat e shërbimit, duke ndihmuar në rritjen e presionit. Në vitet e ardhshme parashikohet të realizohet faza e parë e investimit për ndërtimin e ITUN për qytetin e Shkodrës, duke ndikuar në rritjen me treguesit të mbulimit me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura.

- Uji pa të ardhura parashikohet të reduktohet gjatë viteve të ardhshme duke arritur në nivelin 56% në fund të vitit 2027. Arritja e këtij objektivi është ngushtësisht e lidhur me realizimin e investimit kapital të ndërtimit të linjës kryesore të transmetimit nga stacioni i pompimit Dobraç, deri në pusetën e Rusit. Në tubacionet ekzistuese të transmetimit ka shumë ndërhyrje të paligjshme të cilat ndikojnë rritjen e humbjeve reale të ujit. Nga departamenti teknik do të zbatohen programe për menaxhimin e presionit, zbulimin e rrjedhjeve të fshehura, zvogëlimin e zonave të ndërprerjes së furnizimit me ujë nga riparimet, rritjen e shpejtësisë dhe cilësisë së riparimeve të rrjetit. Drejtoria Tregtare nga ana tjetër, do të rrisë përpjekjet e saj për rregullimin e situatës që lidhet me konsumin e pamatur dhe i pafaturuar për shkak të matjes jo të duhur, vjedhjes së ujit dhe gabimeve njerëzore, duke u bazuar në rritjen e kontroleve ndaj matësve të instaluar, instalimin e duhur të matësve etj.

- Niveli i matjes parashikohet të rritet për vitet e ardhshme, duke arritur në nivelin 100% në fund të vitit 2027. Me qëllim që të arrihet ky objektivi duhet të realizohen investime në instalimin e matësve të ujit tek klientët, të cilët kanë problematika të ndryshme teknike, që lidhen me sistemin e furnizimit (sistemet kolone). Instalimi i matësve do ta ndihmonte shoqërinë në pasjen e nje kontrolli më të lartë mbi konsumin e ujit nga ana e konsumatorëve të saj, marrëdhënie më korrekte me konsumatorët, si dhe nivel më të lartë kontrolli ndaj klientëve jo-pagues.

- Përmirësimi i kohëzgjatjes së furnizimit me ujë, është një objektivi shumë i rëndësishëm për shoqërinë dhe do të arrihet në sajë të rishikimit të grafikëve të punës së agregatëve punues të furnizimit me ujë të zonave rurale.

- Shoqëria rajonale UK Shkodër është e përkushtuar të rrisë efikasitetin e përdorimit të energjisë për të mbajtur nën kontroll dhe zvogëluar këtë zë të rëndësishëm të shpenzimeve. Për të arritur këtë ne angazhohemi në zëvendësimin e pompave që dalin jashtë përdorimit me pompa me parametra teknik që kanë efikasitet më të lartë energjike. Përdorimi i teknologjive të reja për shfrytëzimin e burimeve alternative për energjinë elektrike që konsumohet nga stacionet tona të operimit, është e vështirë, pasi nuk kemi burime të mjaftueshme kapitale për financimin e tyre. UKRSH mbetet e angazhuar në rritjen e efikasitetit të energjisë elektrike, duke optimizuar edhe kohën e operimit të

agregatëve punues. Parashikohet të vihet në operim sistemi SCADA i ITUN Velipojë, me qëllim rritjen e efikasitetit të punës së këtij impianti.

- Në sajë të strukturës së re të organizimit janë krijuar struktura të posaçme për rritjen e kontrollit në terren, ku ndër të tjera detyrat e tyre funksionale lidhen edhe me ndjekjen e debitorëve të shoqërisë, për të mos lejuar rritjen e mëtejshme të borxhit që klientët i kanë shoqërisë. Grupet e terrenit në bashkëpunim me degën teknike do të realizojnë ndërprerjen e furnizimit me ujë për të gjithë klientët debitorë, të cilët nuk i përgjigjen kërkesës së shoqërisë për pagesën e debisë së plotë, apo me këste, sipas akt-marreveshjes së nënshkruar prej tyre. Me qëllim rritjen e aksesit të klientëve në mënyrat e pagesës së faturës, ka arka për realizimin e pagesave në të gjitha rajonet. Rajoni i Shkodrës ka arka të hapura nga mëngjesi deri në mbremje. Përveç arkave, klientët mund të paguajnë edhe në të gjitha bankat, si dhe pranë operatorëve privat si WesterUnion, MoneyGram, Posta Shqiptare, etj.

- Në sajë të rregullimit të tarifave do të mundësohet mbulimi i kostove operative të shoqërisë për vitet e ardhshme, dukë arritur mbulimin e kostove operative në nivelin 100%, ndërsa kostot totale nuk arrijnë të mbulohen në nivelin 100% me këtë nivel tarifash të propozuar.

- Niveli i shpenzimeve të vitit 2023, nuk paraqet realitetin për nivelin faktik të shpenzimeve me të cilat përballlet shoqëria, pasi për këtë periudhë niveli i shpenzimeve është mbajtur në nivelin minimal, përse i përket shpenzimeve të mirëmbajtjes. Shpenzimet e personelit kanë një peshë shumë të madhe e cila parashikohet të rritet në vitet e ardhshme, në respektim të rritjes së pagës minimale dhe nivelit të pagave të punonjësve të tjerë për rrjedhojë. Me qëllim mbajtjen e njerëzve të kualifikuar është e domosdoshme kjo rritje e pagës, pasi ka një nivel interesi shumë të ulët të njerëzve të kualifikuar për t'u bërë pjesë e skuadrës drejtuese të shoqërisë ujësjellës kanalizime.

Tabela 12 Niveli i Treguesve Kryesorë të Performancës

Treguesit e Performancës		Njësia	Treguesit e Performancës sipas Shoqërisë			
			Viti 2023	Periudha Rregullatore		
				Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
1.1	Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë	%	51,96%	53%	54%	55%
1.2	Mbulimi me shërbimin me kanalizime	%	32,54%	32,99%	33,24%	33,49%
1.3	Mbulimi me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura	%	6,02%	6,33%	7,00%	7,72%
2.1	Uji Pa te Ardhura	%	67,01%	60,36%	59,31%	56,07%
2.2	Uji Pa te Ardhura	m ³ /km/d	27,84	22,28	21,20	18,70
3	Niveli i Matjes	%	0,75	0,79	0,84	0,90
4	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë	orë/ditë / popullsi	20,70	21,24	21,34	22,28
5.1	Efikasiteti i Energjisë për ujin	kwh/m ³	0,78	0,77	0,76	0,75

5.2	Efikasiteti i Energjisë për kanalizime dhe trajtim të ujërave të ndotur	kwh/m3	1,18	1,12	1,05	0,91
6	Eficienta e stafit	nr/nr/1000	1,49	1,44	1,41	1,38
7.1	Ankesat e Klientëve	%	15,10%	14,14%	13,49%	13,44%
7.2	Ankesat e Klientëve që kanë marrë përgjigje	%	89,99%	92,71%	96,64%	97,50%
7.3	Ankesat e Klientëve që kanë marrë zgjidhje	%	89,99%	92,71%	96,64%	97,50%
8.1	Norma Korrente e Arkëtimit	%	72,00%	74,14%	75,27%	77,32%
8.2	Norma e Përgjithshme e Arkëtimit	%	92,88%	100,19%	100,36%	100,42%
9.1	Mbulimi i Kostos Operacionale për Ujin	%	75,17%	100,00%	100,00%	100,00%
9.2	Mbulimi i Kostos Operacionale për Kanalizimet	%	79,55%	100,00%	100,00%	100,00%
9.3	Mbulimi i Kostos Operacionale për Trajtimin e Ujërave të Ndotura	%	0,00%	100,00%	100,00%	100,00%
9	Mbulimi OM per të dyja shërbimet	%	75,77%	106,12%	106,30%	106,51%
10.1	Mbulimi i Kostos Totale për Ujin	%	37,32%	56,13%	57,01%	57,96%
10.2	Mbulimi i Kostos Totale për Kanalizime	%	78,74%	98,97%	98,97%	98,97%
10.3	Mbulimi i Kostos Totale per Trajtimin e Ujërave të Ndotura	%	0,00%	98,97%	98,97%	98,97%
10	Mbulimi TOTAL për të dyja shërbimet	%	40%	64%	65%	66%

2.4 Justifikimi i tarifës së re të kërkuar

Politika e tarifave të shërbimit për shoqërinë rajonale UK Shkodër ndërtohet mbi konceptin e mbulimit të kostove dhe mbështetet në gjenerimin e mjaftueshëm të të ardhurave për mbulimin e kostove të saj. Kjo Politikë dhe Strategji bazohet në vlerësimin e performancës aktuale të UK Shkodër dhe në qëllimet e vendosura për të ardhmen. Për parashikimin e parametrave dhe indikatorëve financiarë për vitet 2025-2027, është përdorur modeli standard financiar i dhënë nga rregullatori, janë konsideruar disa supozime si edhe Objektivat Strategjike të shoqërisë.

Mbulimi i kostove dhe Politika e Strategjia Tarifore e shoqërisë rajonale UK Shkodër bazohet në supozimet dhe masat përmirësuese të mëposhtme:

- Rritje e eficiencës së arkëtimeve të përgjithshme në nivelin 100% në fund të vitit 2027.

- Parashikimet për shitjet e shërbimeve ujësjellës dhe kanalizime të cilat bazohen në të dhënat historike, parashikimet për zhvillimin dhe vlerësimin e rritjes së popullsisë, konsumin e ujit për frymë dhe zhvillimin e kërkesës nga abonentët jo-familjarë (institucione dhe biznese).
- Uji Pa të ardhura (UPA) pritet të ulet nga 69% (vlera e vlerësuar për vitin 2023), në 56% në vitin 2027.
- Numri punonjësve parashikohet të zvogëlohet nga 483 aktualisht duke arritur në 450 në fund të vitit 2027. Pavarësisht se numri i punonjësve parashikohet në rënie, kostot e projektuara të stafit janë në rritje, si rrjedhojë e parashikimit për rritje të nivelit të pagës minimale dhe për rrjedhojë edhe e pozicioneve të tjera.
- Niveli i kostove të përgjithshme ndjek nivelet aktuale të rritjes së çmimeve (inflacioni, kosto e punës).

Shoqëria ka zhvilluar një strategji të kombinuar fikse dhe volumetrike për rregullimin e tarifave, të cilën shoqëria do t'ia dërgojë ERRU për aprovim.

Për çmimet volumetrike, shoqëria rajonale UK Shkodër planifikon një rritje të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë për këto kategori klientësh: Familjarë, Biznese dhe Institucione Buxhetore. Këto tarifa do të fillojnë të zbatohen në vitin 2025. Përveç kësaj shoqëria propozon një rritje çmimi edhe për shërbimet e kanalizimeve duke filluar nga viti 2025 për të tre kategoritë e klientëve, justifikuar kjo me kostot e larta të operimit dhe mirëmbajtjes. Tarifa e kanalizimeve përfshin mbulimin e kostove për çdo proces trajtimi të ujërave të ndotura që kryhet.

2.4.1 Tarifa mesatare për metër kub ujë i pijshëm dhe kanalizime

Shoqëria UK Shkodër për shërbimin që ofron, aplikon tarifat e shërbimit, me qëllim mbulimin e kostove Kostot Direkte dhe Kostove Totale, që vijnë si rrjedhojë e kryerjes së shërbimit. Tabela e mëposhtme tregon nivelin mesatar të tarifave dhe kostove me të cilat përballet shoqëria, sipas shërbimit që ofrohet.

Shërbimi furnizimit me ujë. Për vitin 2023, Kostot Direkte dhe Totale Operacionale janë më të larta se të ardhurat nga zbatimi i strategjisë së Tarifave respektivisht me -20.8 dhe -51.81 Lekë/m³, e cila përfaqëson humbje në dhënien e shërbimit. Në vitin 2025 dhe më pas, të ardhurat do të mbulojnë kostot operative dhe do të sigurojnë një tepicë me vlerë 0.06 Lekë/m³ për Kostot Operacionale Direkte dhe do të zvogëlojnë humbjet në mbulimin e Kostove Operacionale Totale në -24.13 Lekë/m³ në përfundim të periudhës.

Shërbimi Kanalizime. Për vitin 2023, Kostot Direkte dhe Totale Operacionale janë më të larta se të ardhurat nga zbatimi i strategjisë së Tarifave respektivisht me -15.11 dhe -49.84 Lekë/m³ e cila përfaqëson humbje në dhënien e shërbimit. Në vitin 2025 dhe më pas, të ardhurat janë parashikuar të mbulojnë plotësisht KOD dhe të zvogëlojnë humbjet në mbulimin e Kostove Operacionale Totale në -36.27 Lekë/m³ në vitin 2025 dhe -31.13 Lekë/m³ në vitin 2027.

Tabela 13. Tarifa mesatare për metër kub (Lekë/m³)

Furnizimi me ujë lekë/m³	2023	2025	2026	2027
Kosto Operacionale Direkte				
Kosto mesatare KOD për 1 m ³ ujë të faturuar	84.17	98.94	97.51	96.75
Tarifa mesatare për 1 m ³ ujë të faturuar*	63.37	100.00	100.34	99.97
Diferenca ndërmjet Të Ardhura-Kosto KOD	-20.80	1.07	2.83	3.22
Kosto Operacionale Totale				
Kosto mesatare KOD për 1 m ³ ujë të faturuar	115.18	127.85	125.78	124.10
Tarifa mesatare për 1 m ³ ujë të faturuar	63.37	100.00	100.34	99.97
Diferenca ndërmjet Të Ardhura-Kosto KOT	-51.81	-27.85	-25.44	-24.13
Kanalizime lekë/m³				
Kosto Direkte Operacionale				
Kosto mesatare DOC për 1 m ³ ujë të faturuar	30.41	37.85	40.67	40.23
Tarifa mesatare për 1 m ³ ujë të faturuar*	15.30	40.53	40.28	40.25
Diferenca ndërmjet Të Ardhura-Kosto KOD	-15.11	2.69	-0.39	0.02
Kosto Totale Operacionale				
Kosto mesatare TOC për 1 m ³ ujë të faturuar	65.13	70.54	71.85	70.55
Tarifa mesatare për 1 m ³ ujë të faturuar	15.30	34.27	39.51	39.42
Diferenca ndërmjet Të Ardhura-Kosto KOT	-49.84	-36.27	-32.34	-31.13

2.4.2 Vlerësimi i Përballueshmërisë

Pavarësisht se rritja e propozuar e tarifave është jetike për shoqërinë për mbulimin e kostove të ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe grumbullim/trajtim i ujërave të ndotura, ajo konsideron dhe vlerëson aftësinë e abonentëve familjarë për të përballuar këtë rritje.

Analiza e përballueshmërisë është kryer për klientët familjarë me qëllim që të vlerësohet ndikimi i rritjes së tarifave dhe aftësia e tyre për të paguar. Për këtë qëllim, u llogarit një normë përballimi (në %) duke pjesëtuar vlerën e faturave mujore të shërbimeve ujësjellës kanalizime me mesataren mujore të shpenzimeve të familjarëve.

Bazuar në vëzhgimin më të fundit të disponueshëm mbi buxhetet familjare të kryer nga INSTAT në vitin 2022, shpenzimet mujore mesatare të familjeve në qarkun Shkodër, ishin mesatarisht 83.014 Lekë. Bazuar në këto vlera, rezulton se niveli i përballueshmërisë së shërbimit është në nivelin 1.6%. Analiza e përballueshmërisë u krye për të ardhurat e nevojshme që u shoqërisë i duhen mbulimin e kostove direkte dhe rezulton të jetë më e ulët se kufiri prej 5% të vlerës totale të shpenzimeve të familjes, që është politikë e përballueshmërisë e zbatuar nga ERRU.

Tabela 14 Tabela e Analizës së faturave mujore

Rajoni	Konsumi mesatar me matje	Konsumi mesatar pa matje	Konsumi mesatar	Fatura mesatare Ishte	Fatura mesatare Propozohet	Rritja lek	Pjesa që zë në të ardhurat mesatare mujore
Shkodër	9.68	16.15	12	912	1,824	912	2.2%
Konsumi mesatar mujor i familjeve të Qarkut Shkodër							83,014

Janë marrë në analizë tre fasha kryesore konsumi mesatare, nga ku rezulton se pjesa që zë kostoja mesatare e faturës së ujit me TVSH është nën nivelin prej 5% të totalit të të ardhurave mesatare të familjes, që konsiderohet si kufiri i përballueshmërisë për kategorinë e klientëve familjarë. Në ndihmesë të familjeve në ndihmë ekonomike vjen edhe zbatimi i skemës së re të subvencionit nga AKUK, e cila do të mundësojë subvencionimin e një pjese të konsumit mujor, për këtë shtresë vulnerabël të shoqërisë.

Si rezultante e ndryshimit të tarifave dhe rritjes së sasisë së ujit të shitur nga rritja e numrit të klientëve nga zgjerimi i zonës së shërbimit, parashikohet që të ardhurat nga shitja të rrisin aftësinë paguese të shoqërisë duke bërë të mundur mbulimin e shpenzimeve operative dhe shpenzimet për instalim matësa uji tek klientët dhe riparime të disa linjave tepër të amortizuara dhe problematike për mirëmbajtjen.

Si përfundim theksojmë sërish nevojën e ndryshimit të tarifave për ujin e pijshëm dhe ujërat e përdorura, ndikuar edhe nga rritja e vazhdueshme e kostove të operimit të veprimtarisë kryesore të UKRSH-së dhe nevojës për rritjen e pavarësisë financiare me qëllim arritjen e mbulimit të shpenzimeve të operimit në nivelin 100%.

Besmir LESHJA

ADMINISTRATOR

